

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6045
E mërkurë, 24 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Prizrenasja zgjedhet kryetare e Parlamentit të Kantonit të Lucernit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

Për dialogun me Serbinë duhet delegacion me bazë të gjerë

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se Kosovës i duhet unitet në procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se për këtë proces Kosovës i duhet një delegacion me konsensus më të gjerë sesa qeveria dhe presidenti. Ajo ka shprehur optimizëm se procesi i dialogut është kthyer në binarët e duhur pas distancimit të administratës amerikane nga shkëmbimi i territoreve. Tahiri ka vlerësuar se ShBA-ja dhe BE-ja do ta plotësojnë njëra-tjetrën në fazën finale të dialogut. Sipas saj, delegacioni i Kosovës në këtë proces duhet ta mbrojë shtetin dhe Kushtetutën e Kosovës



KUVENDI SËRISH DËSHTON T'I RATIFIKOJË MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Kuvendi i Kosovës as të martën nuk ka rritur t'i ratifikojë pesë marrëveshje ndërkombëtare financiare pasi partitë opozitare nuk pranuan t'i votojnë ato. Në mungesë të kuorumit, seanca është shtyrë. Gjatë kësaj seance u tha

se mungesa e vullnetit, e guximit dhe e konsensusit politik e institucional për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku bien edhe ato financiare, mund të prodhojë efekte negative afatgjata. Analistët politikë

kanë theksuar se marrëveshjet ndërkombëtare që ndihmojnë rimëkëmbjen ekonomike janë shumë të rëndësishme dhe nuk duhet të refuzohen shkak i inateve personale a partiake

THAÇI DHE HOTI HARMONIZOJNË QËNDRIMET PARA UDHËTIMIT NË SHBA



KULLA NË FSHATIN ÇADRAK TË SUHAREKËS U NËNSHTROHET NDËRHYRJEVE RESTAURUESE-KONSERVUESE



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Haradinaj-Stublla: Kosova dhe Shqipëria, duke qenë bashkë, e kanë ndërtuar të kaluarën dhe të tashmen



PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - "Kosova dhe Shqipëria e kanë ndërtuar të kaluarën dhe të tashmen, duke qenë një dhe po në këtë trase, do ta vazhdojmë rrugëtimin tonë", ka thënë të martën ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, në takim që ka zhvilluar me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. "Sot në një takim

shumë të përzemërt me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi, ritheksuam nevojën e një dinamike të re bashkëpunimi dhe aspirate drejt integritit euroatlantik dhe avancimit të prioritetëve tona të përbashkëta", ka thënë Haradinaj-Stublla. Në këtë takim kryediplomatja e Kosovës falënderoi ambasadorin

Minxhozi edhe për kontributin e jashtëzakonshëm të Shqipërisë në të gjithë rrugëtimin e shtetëndërtimit të Kosovës, që nga çlirimi e në vazhdimësi. "Po ashtu, kërkoja mbështetjen e Shqipërisë edhe më tutje në proceset që i kemi përpara, që janë jetike për Kosovën dhe për çështjen shqiptare në përgjithësi", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla.

Prizrenasja zgjedhet kryetare e Parlamentit të Kantonit të Lucernit

PRISHTINË, 23 QERSHOR - "Jam e emocionuar dhe mirënjohëse që më votuat përkundër faktit se jam me prejardhje të huaj. Faleminderit shumë!", ka thënë Ylfete Fanaj në gjuhën shqipe pasi është zgjedhur kryetare e Parlamentit të Kantonit të Lucernit.

Ajo ka thënë se falë votës së deputetëve është bërë lucernasja e parë e Lucernit. "Sot ka ndodhur diçka e paimagjinueshme: falë votimit tuaj jam lucernasja numër 1. Me këtë votim keni bërë të mundur që 50 vjet pas hyrjes në fuqi të së drejtës së votës për gratë, të zgjedhet një grua, me prejardhje të huaj, në postin më të lartë politik të kantonit. Këtë e bën të mundur Zvicra", ka thënë Fanaj.

Ajo ka përsëritur edhe faktin se po në këtë sesion të parlamentit është zgjedhur për herë të parë një kryetare me prejardhje të huaj.

Fanaj ka përsëritur dhe falënderuar edhe prindërit e saj për mbështetjen që i kanë ofruar për ngritjen e saj shkollore dhe politike.

Zgjedhja e Ylfete Fanajt në postin e kryetares së Parlamentit të Kantonit të Lucernit është rasti i parë jo vetëm në këtë kanton që zgjedhet një grua me prejardhje të huaj në këtë nivel kaq të lartë. Këtë e kanë theksuar në fjalët e tyre përsëritëse kryetari i deritashëm i parlamentit, Josef Wyss, kryetari i Qeverisë së Kantonit të Lucernit, Paul Winkler etj.



Quni zhvilloi bisedë telefonike me homologun malazez, diskutuan për Covid-19

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, të martën ka zhvilluar një bisedë telefonike me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Malit të Zi, Predrag Boshković.

Në frymë miqësie e partneriteti, të dy ministrat kanë biseduar për nivelin e bashkëpunimit të deritashëm dhe shkallën e implementimit të marrëveshjes bilaterale në mes dy ministrive. Ndër të tjera, ata kanë diskutuar për procesin e menaxhimit të pandemisë Covid-19 në nivele shtetërore, për strategjitë e dy ministrive, operacionet e forcave gjatë emergjencës si dhe për sfidat e shfaqura gjatë luftimit të saj.

Të dy u pajtuan që pas pandemisë kontaktet të shtohen me vizita të ndërsjella



për ta thelluar bashkëpunimin bilateral në të mirë të paqes dhe sigurisë së dy vendeve si dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

Dialogu Kosovë - Serbi vazhdon në muajin korrik, thotë zëdhënësi i BE-së

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, konfirmoi se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës do ta vazhdojë në muajin tjetër. Stano ka theksuar se BE-ja po vazhdon angazhimin e plotë në këtë drejtim, duke përmendur vizitën e përfaqësuesit të posaçëm të BE-së, Miroslav Lajčak, në Prishtinë dhe Beograd. "Si rezultat i bisedimeve të tij ne mund të njoftojmë se dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës do të vazhdojë në korrik", ka thënë Peter Stano. Ai ka shpjeguar se ende nuk ka një datë specifike, por që të dyja palët kanë rënë dakord për vazhdimin e dialogut në Bruksel dhe se aktualisht janë duke punuar për caktimin e një date. Presidenti serb Aleksandar Vučić dhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, pritët ta vizitojnë Brukselin gjatë kësaj jave për bisedime me zyrtarët evropianë.



Sipas zëdhënësit të BE-së, këto do të jenë "vizita të ndara dypalëshe", të cilat nuk kanë lidhje me vazhdimin e dialogut. Vuçiqi dhe Hoti do të qëndrojnë në Bruksel para takimit të ardhshëm midis delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë në Shtëpinë e Bardhë në Uashington më 27 qershor. (rel)

Kuvendi sërish dështon t'i ratifikojë marrëveshjet ndërkombëtare

Kuvendi i Kosovës as të martën nuk ka rritur t'i ratifikojë pesë marrëveshje ndërkombëtare financiare pasi partitë opozitare nuk pranuan t'i votojnë ato. Në mungesë të kuorumit, seanca është shtyrë. Gjatë kësaj seance u tha se mungesa e vullnetit, guximit dhe konsensusit politik e institucional për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku bien edhe ato financiare, mund të prodhojë efekte negative afatgjata. Analistët politikë kanë theksuar se marrëveshjet ndërkombëtare që ndihmojnë rimëkëmbjen ekonomike janë shumë të rëndësishme dhe nuk duhet të refuzohen shkaku i inateve personale a partiake



problemeve ngatërrestare pa fund", ka thënë Tahiri.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka akuzuar partitë në pushtet për mungesë të bashkëpunimit. "Prioritetet i keni pasur të gabuara. Nuk i keni sjellë në kohë për miratim, nuk keni ofruar bashkëpunim për temat e rëndësishme në këtë Kuvend", ka deklaruar Hamza.

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Kujtim Shala, ka thënë se opozita ka të drejtë të votojë kundër, por duhet të ketë argumente me të cilat i kundërshton marrëveshjet ndërkombëtare.

Në lidhje me mosvotimin e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare ka reaguar opinionisti Imer Mushkolaj, i cili ka thënë se deputetët nuk paguhen për t'i dëgjuar teksta shajnë njëri-tjetrit, por për të votuar ligje për të mirën e qytetarëve. "Ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që ndihmojnë rimëkëmbjen ekonomike janë shumë të rëndësishme dhe nuk duhet të refuzohen shkaku i inateve personale a partiake", ka thënë Mushkolaj.

Këto ishin projektligjet që do të duhej të votoheshin në seancën e së martës në Kuvend dhe për të cilat duheshin votat e 2/3 të deputetëve të pranishëm: Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për financim në mes të Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e fuqizimit të sektorit financiar; Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës

kadastër të patundshmërisë dhe infrastrukturës gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim; Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Dogana 2020"; si dhe Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Fiskalis 2020".

Këto marrëveshje ndërkombëtare edhe në një seancë paraprake nuk kishin gjetur mbështetjen e deputetëve për të kaluar.

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka dështuar sërish që t'i ratifikojë të martën pesë marrëveshje ndërkombëtare, nga të cilat vendi mund të përfitonte miliona euro. Debati në këtë seancë është karakterizuar me polemikë të ashpra mes pozitës dhe opozitës.

PDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje refuzuan votimin e këtyre marrëveshjeve, duke drejtuar gishtin kah qeveria Hoti të cilën ata e quajnë qeveri e mashtrimit. Në fund të debatit, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka kërkuar edhe nga opozita që këto marrëveshje të miratohen, mirëpo kjo nuk ndodhi. Në momentin e votimit vetëm 58 deputetë votuan për, gjë që do të thotë se nuk pati kuorum për vazhdimin tutje.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka reaguar pas dështimit të ratifikimit të pesë marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Kuvendit. Me këtë rast, ai ka thënë se qytetarët e Kosovës kanë nevojë urgjente për mbështetje institucionale. "Kuvendi i Kosovës dështoi t'i votojë sot pesë marrëveshje ndërkombëtare. Këto dokumente që presin të votohen janë të një rëndësie të veçantë për shkak se janë marrëveshje ekonomike për projekte investive dhe zhvillimore në Kosovë. Qytetarët e Kosovës kanë nevojë urgjente për mbështetje institucionale, ndërsa

Qeverisë së Kosovës duhet t'i lejojë ta vazhdojë implementimin e masave në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike. Andaj, ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që, të paktën, kur kemi të bëjmë me projekte zhvillimore dhe fonde mbështetëse për infrastrukturë, t'i marrim përgjegjësitë kushtetuese që na takojnë. Në Kuvend duhet t'i hapet rrugë diskutimit për buxhetin e rishikuar, që t'i dalim në krah të bizneseve të cilat rrezikojnë të shuhen, t'u dalim në krahë punëtorëve që nuk i kanë marrë pagat, ta mbrojmë prodhimin vendor dhe t'i mbështesim qytetarët në nevojë", ka thënë Haradinaj.

Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, ka thënë se mungesa e vullnetit, guximit dhe konsensusit politik e institucional për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku bien edhe ato financiare, mund të prodhojë efekte negative afatgjata. "Me këtë qasje dobësohet kredibiliteti negociues i Kosovës kundrejt institucioneve financiare ndërkombëtare. Për më keq, kjo mund të rezultojë me ngushtimin e mundësive në të ardhmen për projekte zhvillimore dhe/apo të rimëkëmbjes. E kuptoj shumë mire politikën ditore, por është koha e fundit t'i kthehemi interesit publik e qytetar, të jemi më pragmatikë e më të përgjegjshëm karshi sfidave. Debati duhet t'u shërbejë zgjidhjeve dhe konsensusit, assesë përplasjeve e

dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Gjilan; Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për financimin e projektit për

Demokracia Plus kërkon nga Kuvendi ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

"Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Kuvendit të Kosovës bëhet me votat e shumicës së kualifikuar, apo të paktën dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Ky prag i votimit është më i lartë sesa për zgjedhjen e qeverisë që kërkon votat e shumicës absolute të deputetëve. Ky është një tregues se votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kërkon një konsensus më të gjerë politik, që shkon përtej shumicës parlamentare që mund të përbëjë koalicionin qeverisës", është thënë në komunikatën e Demokraci Plus.

Sipas Demokracia Plus, një numër i marrëveshjeve ndërkombëtare për gati një vit pret ratifikimin nga Kuvendi. "Shumica prej këtyre marrëveshjeve janë negociuar nga dy qeveritë paraprake që, ndër të tjera, kanë të bëjnë me zbatimin e projekteve infrastrukturore që prekin përmirësimin e shërbimeve bazike për nevojat e qytetarëve, siç është Marrëveshje për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Gjilanit, por edhe marrëveshje të tjera të cilat do të

lehtësojnë përballje me pasojat ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Rimëkëmbja ekonomike e vendit nuk është vetëm obligim i qeverisë, as vetëm i një subjekti politik, është përgjegjësi e të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvend që kanë marrë besimin e qytetarëve për t'i përfaqësuar. Bllokimi i votimit të këtyre marrëveshjeve për inate politike të së kaluarës është papërgjegjësi e madhe që shkon në dëm të qytetarëve dhe bizneseve të vendit", thuhet në komunikatën DP.

Demokracia Plus ka kërkuar nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që t'i lënë anash dallimet politike dhe ambicjet për pushtet dhe të përqendrohen në luftën ndaj pandemisë dhe rimëkëmbjen ekonomike të vendit. "Në këtë drejtim, bëjmë thirrje që marrëveshjet ndërkombëtare të cilat kërkojnë ratifikimin nga Kuvendi, të trajtohen me seriozitetin më të lartë individualisht dhe të mos refuzohen pa pasur vërejtje për përmbajtjen e tyre", theksohet në këtë komunikatë.

Në Klinikën Infektive të QKUK-së vdes edhe një pacient

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka njoftuar se të martën në orët e mëngjesit ka vdekur një pacient, i dyshuar për infeksion me Covid-19, për të cilin pritet konfirmimi i rezultateve nga laboratorit mikrobiologjik.

Në këtë Klinikë, sipas njoftimit, janë të hospitalizuar 104

raste, prej të cilëve të sëmurë me Covid-19 janë gjithsej 101 raste. "Prej tyre, 51 raste janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, 6 raste janë duke u trajtuar në Repartin e Mjekimit Intensiv, 5 prej tyre janë në gjendje kritike", thuhet në njoftim.

Të martën nga Klinika do të lirohen dy raste të të shëruarve

nga Covid-19 si dhe do të lirohet një rast pozitiv për vetizolim në shtëpi pasi është në gjendje stabile.

Marrë parasysh të dhënat e fundit, që prej shfaqjes së rasteve të para me koronavirus në Kosovë më 13 mars dhe deri më tani, janë regjistruar 2 216 raste me Covid-19, prej të cilëve 1 069 janë shëruar, ndërsa 38 kanë vdekur.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, EDITA TAHIRI

PËR DIALOGUN ME SERBINË DUHET



Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se Kosovës i duhet unitet në procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ajo ka thënë se për këtë proces Kosovës i duhet një delegacion me konsensus më të gjerë sesa qeveria dhe presidenti. Ajo ka shprehur optimizëm se procesi i dialogut është kthyer në binarët e duhur pas distancimit të administratës amerikane nga shkëmbimi i territoreve. Tahiri ka vlerësuar se ShBA-ja dhe BE-ja do ta plotësojnë njëra-tjetrën në fazën finale të dialogut. Sipas saj, delegacioni i Kosovës në këtë proces duhet ta mbrojë shtetin dhe Kushtetutën e Kosovës

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 QERSHOR -

“Epoka e re”: Znj. Tahiri, shumë shpejt pritet të rifillojë dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë. A është e gatshme Kosova për këtë proces?

Tahiri: E gjithë bota është përfshirë në pandemi. Sigurisht se në këtë kohë prioritet janë shëndeti dhe rimëkëmbja ekonomike.

Mirëpo disa procese që ndikojnë në paqe dhe stabilitet janë të pashmangshme. Prandaj, mendoj se angazhimet e Uashingtonit dhe të Brukselit që ta rinisin këtë dialog janë me vend. Kosova ka pasur disa ndryshime politike, tani kemi qeverinë e re dhe mendoj se ka mundësi dhe mund të ketë edhe vullnet që të jemi në dialog, qoftë në Bruksel apo në Uashington.

“Epoka e re”: Tanimë janë caktuar edhe datat për rifillimin e dialogut. Fillimisht më 27 qershor në Uashington, pastaj në korrik në Bruksel. Cili është qëndrimi juaj për këto takime?

Tahiri: Së pari dua të them se Kosova është një çështje euroatlantike, pra kjo kornizë euroatlantike vjen që nga koha e pavarësimit dhe shtetndërtimit. Vizioni ynë është Kosova euroatlantike,

prandaj angazhimi i ShBA-së dhe BE-së për ta ndihmuar arritjen e një marrëveshje të qëndrueshme paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i mirëpritur. Zgjidhja e këtij problemi duhet të çojë te njohja reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pa prekur kufijtë e dy shteteve. Nga ajo që kam informacione dhe po analizoj, proceset kanë ndryshuar në kuptimin e qëndrimeve në Bruksel dhe në Uashington. Pra, qëndrimet kanë ndryshuar për të mirë nga viti i kaluar, kur kancelarja Merkel në samitin e Berlinit ndërpreu rrugën e lojërave për ndryshim të kufijve. Tanimë ky qëndrim po forcohet në të gjithë BE-në. Gjithashtu kemi edhe qëndrimin zyrtar të përfaqësuesit special të ShBA-së për dialog, Richard Gerenell, i cili tha se administrata e Trumpit është kundër shkëmbimit të territoreve. Kjo

tregon se procesi i dialogut mund të shkojë pikërisht në drejtim të krijimit të një paqe të qëndrueshme dhe të stabilitetit. Pra, tani mendoj se proceset po lëvizin në drejtimin e duhur.

“Epoka e re”: Me këto takime të ndara në Uashington dhe Bruksel po fitohet përshtypja se ShBA-ja dhe BE-ja po bëjnë garë në këtë proces dhe po flasin për dy procese të ndara?

Tahiri: Në fakt, kjo përshtypje ishte krijuar më përpara. Mirëpo kur u bënë të njohura agjendat, sidomos nga Uashingtoni u pa se ka një komplementaritet në këto përpjekje. Uashingtoni po flet për një agjendë ekonomike dhe për një normalizim ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dhe u tha se çështjet politike ia lënë Evropës. Dialogu i Brukselit për atë kohë sa e kam

DELEGACION ME BAZË TË GJERË



Kosovës. Pra, nuk mund të ketë ndikime ndërkombëtare që mund ta devijojnë pozicionin e delegacionit të Kosovës në mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, si dhe Kushtetutën e Kosovës. Kjo është vijë e kuqe në çdo proces negociator.

“Epoka e re”: Kohët e fundit shumë liderë politikë në vend, duke përfshirë edhe presidentin, e shohin me skepticizëm rolin e BE-së në këtë proces. Sa është e gatshme BE-ja ta përmbyllë këtë proces?

Tahiri: Z. Thaçi si president i Kosovës do të ishte më mirë që një herë të merret me veten, me gabimet që bëri duke hyrë në lojërat për kufij. Së dyti, as Thaçi dhe as Kosova nuk është në gjendje t’i vlerësojë kapacitetet që i ka BE-ja, që sot qartë po udhëhiqet nga Gjermania dhe Franca si dy shtete lidere që morën përsipër t’i korrigjojnë gabimet që bëri Mogherini si përfaqësuese e politikës së jashtme të BE-së. Derisa vetë Gjermania dhe Franca si udhëheqëse të BE-së u morën me korrigjimin e gabimeve, edhe Thaçit i takon të merret me korrigjimin e gabimeve të veta dhe t’i sigurojë qytetarët se ai ka hequr dorë nga lojërat e r r e z i k s h m e .

Në të arriturat historike për Kosovën si konferenca e Rambujesë, bisedimet e Vjenës dhe dialogu i Brukselit, ne i kemi parë bashkë ShBA-në dhe BE-në. Pra, ShBA-ja ka qenë udhëheqëse e ndërmjetësimit, kurse BE-ja ka qenë partnere. Ndërsa në dialogun e Brukselit BE-ja ka qenë udhëheqëse, ndërsa ShBA-ja ka qenë mbështetëse. Kjo praktika e re, e cila ka ndërmjetësim të veçantë nga BE-ja dhe ShBA-ja, nuk duhet të na shqetësojë neve si Kosovë. Ne si palë në këto bisedime e dimë se cilat janë objektivat tona dhe cili është vizioni ynë.

“Epoka e re”: Kosova nuk është unike në këtë proces. Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës që të paraqiten sa më mirë në këtë proces?

Tahiri: Ne si problem kemi mungesën e unitetit. Kemi mungesë uniteti në kuptimin e një platforme të unifikuar dhe krijimin e një delegacioni me konsensus më të gjerë sesa një qeveri dhe një president. Pas takimeve në Bruksel dhe në Uashington, Kosova menjëherë duhet ta ketë fokusin në krijimin e delegacionit shtetëror, i cili do të miratohet

nga Kuvendi i Kosovës. Qeveria ka kompetencë që të jetë udhëheqëse e dialogut, pra kryeministri. Mirëpo kjo nuk mjafton, meqenëse po flasim për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Meqenëse ky proces është historik, atëherë Kosova duhet ta ketë një delegacion me një bazë më të gjerë. Sepse, në fund, çfarëdo marrëveshje paqësore që do të arrihet, duhet të miratohet nga Kuvendi me dy të tretat e votave.

“Epoka e re”: Sa jeni optimiste se me këtë përfaqësim special të ShBA-së dhe BE-së do të mund të përmbillet ky proces?

Tahiri: Unë po shoh dy ndërmjetësues, me dy qasje që plotësojnë njëra-tjetrën. Uashingtoni shprehu angazhim për çështje ekonomike dhe BE-ja për çështje politike. Nëse e shikojmë për nga përmbajtja,

mund të jetë një kombinim interesant për këtë proces dhe për një përfundim final të marrëveshjes. Në anën tjetër, dy ndërmjetësues, edhe pse mund të duket se nuk janë në koordinim, ata kanë një përvojë dhe një traditë të gjatë të koordinimit për çështje të Ballkanit. Pra, ekziston një traditë e bashkëpunimit që në këtë kohë mund të mos duket shumë intensive, në parime ka koherencë dhe dakordime.

“Epoka e re”: Para takimeve për rifillimin e dialogut, presidenti serb do ta vizitojë Rusinë. Sa i rrezikshëm mund të jetë roli i Rusisë në këtë proces?

Tahiri: Siç po shihet, Vuçiqi nuk shkon as në Bruksel e as në Uashington pa shkuar në Moskë te Putini. Këtu përsëri vjen në shprehje lufta gjeopolitike që po zhvillohet për Ballkanin dhe tendenca e

Rusisë që ta shtrijë ndikimin e saj në Ballkan. Pra, Rusia ende nuk ka hequr dorë nga ëndrrat që të ketë ndikim në Ballkan. Nëse Serbia bën këtë gabim, pra provon të luajë midis Rusisë dhe Perëndimit, humbëse do të jetë Serbia. Dhe në këtë mënyrë Serbia do të vazhdojë të luajë një rol destruktiv në Ballkan. Meqenëse çështja Kosovë - Serbi është çështja e fundit problematike në Ballkan, ky është një test për BE-në, se sa është e vendosur që ta marrë Ballkanin në Evropë. Sa po shoh, gjërat po shkojnë pozitivisht dhe më duket se BE-ja ka marrë një qëndrim më strategjik që Ballkanin mos ta lë me probleme. Procesi po zhvillohet në drejtim të duhur dhe distancimi i administratës së Trumpit nga koha e Boltonit, kur janë luajtur lojërat me kufij, është një ndryshim shumë pozitiv nga Uashingtoni.

Ministri Zemaj viziton Klinikën Infektive, interesohet për kushtet në këtë klinikë

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka qëndruar të martën në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare, ku ka parë nga afër menaxhimin e kësaj klinike dhe punët e tjera me numrin në rritje të rasteve me Covid-19, të cilat janë në tretman spitalor. Ministri Zemaj është informuar nga drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu dhe drejtoresha e Klinikës Infektive, dr. Lindita Ajazaj-Berisha, për numrin e shtuar të pacientëve të shtrirë në këtë klinikë, ku të martën kishte 104 pacientë, prej të cilëve 101 të konfirmuar me Covid-19, por edhe për një numër të caktuar pacientësh,

tashmë të shtrirë në Klinikën e Pulmologjisë, e cila, bashkë me Klinikën e Dermatovenerologjisë dhe Qendrën e Mjekësisë Sportive, janë vënë në dispozicion të trajtimit të rasteve me Covid-19. Me qëllim të përfundimit të kapaciteteve profesionale, ministri Zemaj ka thënë se, përveç stafit aktual të këtyre klinikave, një numër i profesionistëve do të angazhohen edhe përmes rekrutimit të profesionistëve shëndetësorë që është në proces, por edhe përmes vullnetarëve të gatshëm për t’u angazhuar. Në këtë takim është diskutuar edhe për aspekte të tjera të

menaxhimit klinik të rasteve me Covid-19 dhe përfundimit të shërbimeve me qëllim të përballimit të çfarëdo fluksi të pacientëve me Covid-19. Më pas ministri i ka bërë vizitë edhe Qendrës së Mjekësisë Sportive për ta parë mobilizimin e kapaciteteve në funksion të përballjes me Covid-19. Nga takimi në Klinikën Infektive, profesionistët e saj kanë kërkuar nga kolegët e tyre të Kujdesit Parësor që t’i përpunojnë rastet mjekësore ambulatore me kujdes në Klinikë t’i referojnë vetëm rastet me Covid-19, për të mos e ngarkuar klinikën me raste ambulatore dhe pa simptomatologji të qartë klinike për Covid-19.



udhëhequr unë është marrë me procesin e normalizimit të marrëdhënieve fqinjësore ndërmjet të dy shteteve. Nga takimi që pata me z. Lajçak në Prishtinë, ai tha se vazhdimi i dialogut tash është përmbyllje e dialogut që ka filluar në vitin 2011. Ajo çka po shoh unë, është se BE-ja po provon të jetë e suksesshme për ndërmjetësimin dhe përfundimin e kësaj marrëveshje. Sa i përket bashkëpunimit të Francës dhe Gjermanisë, BE-së dhe ShBA-së si aktorët kryesorë për ne në këtë proces, z. Grenell tha se ka qenë në kontakt me këto shtete. Por, kryesorja është se në Kosovë jemi në këtë ekuacion. Dhe delegacioni i Kosovës duhet t’i mbrojtë shtetin, pavarësinë, sovranitetin dhe kufijtë e Kosovës. Kosova duhet të bëjë dialog duke respektuar Kushtetutën e Republikës

Thaçi priti një delegacion nga komuniteti egjiptian, i uroi për 24 qershorin

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të martën ka pritur një delegacion të komunitetit egjiptian, i kryesuar nga deputeti Veton Berisha, për nder të Ditës Kombëtare të Egjiptianëve në Kosovë. Presidenti Thaçi ka thënë se komuniteti egjiptian është pasuri e vendit dhe është sukses i madh që kemi arritur të kemi një harmoni kaq të madhe mes të gjitha komuniteteve në Kosovë. "Çdo komunitet duhet të përket për ruajtjen dhe forcimin e identitetit të vet. Por, duhet të bëhet më shumë për krijimin e kushteve sa më gjithëpërfshirëse të integritetit dhe punësimit të të gjithë

pjesëtarëve të komuniteteve në shoqërinë e Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga komuniteti egjiptian, Veton Berisha, ka theksuar se Kosova ka krijuar bazë të lakmueshme ligjore, ku parashihen të drejta të shumta për komunitetet, por në praktikë po hasin në shumë vështirësi.

Duke e falënderuar presidentin Thaçi për përkrahjen e komunitetit egjiptian, deputeti Berisha ka kërkuar angazhim edhe më të madh për promovimin e të drejtave të komunitetit egjiptian në Kosovë. Presidenti Thaçi u shpreh mirënjohës për kontributin e komunitetit egjiptian në shtetin tonë të ri.



Kulla në fshatin Çadarak të Suharekës u nënshtrohet ndërhyrjeve restauruese-konservuese

PRIZREN, 23 QERSHOR (ER) - Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, në kuadër të zbatimit të politikave programore, ka hartuar projektin për restaurimin e Kullës së familjes Tafolli në fshatin Çadarak të Suharekës.

Zbatimi i këtij projekti do të fillojë së shpejti pasi që janë tejkaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore.

Kulla e Hasan Tafollit, e cila gjendet në fshatin Çadarak të Komunës së Suharekës, është karakteristike për nga tipologjia dhe funksioni. Është ndërtuar në shekullin XIX dhe ka shërbyer kryesisht për banim dhe për ruajtjen e bagëtisë, por sipas nevojave dhe rrethanave të kohës ka pasur edhe funksione të tjera.

Banorët e këtij fshati tregojnë se kjo ndërtesë është shfrytëzuar



edhe si Odë deri në vitet '90, deri kur familja Tafolli është shpërngulur nga fshati dhe

Kulla së bashku me shtëpinë tjetër të banimit janë braktisur tërësisht.

Kulla e gurit e familjes Tafolli është e vendosur mbi kodër dhe ka pozitë dominuese mbi fshatin Çadarak. E ndërtuar në harmoni me ambientin rrethues, kjo kullë është shndërruar në pjesë përbërëse të peizazhit të fshatit. Për shkak rrethanave shoqërore, bujqësia dhe blegtoria kanë qenë burimet kryesore të jetesës që kanë ndikuar edhe në aspektin e zgjidhjes arkitektonike, duke imponuar një funksion të banimit të kombinuar.

Drejtori i Qendrës Rajonale për trashëgimi kulturor në Prizren, Samir Hoxha, thekson se kujdesi dhe mirëmbajtja e aseteve të trashëgimisë kulturore duhet ta ketë çdo ditë e më shumë vëmendjen që e meriton, me theks të veçantë ndërtesat e tilla të cilat paraqesin ndër shembujt e paktë të këtij tipi të kullave të

gurit me çardak druri që kanë mbijetuar në Kosovë. "Si e tillë, kjo kullë prej guri ngërthen në vete vlera të rëndësishme arkitektonike, historike, shoqërore, ambientale dhe ekonomike, andaj se sa dinë njerëzit për trashëgiminë kulturore, varet nga ajo se çka bëhet me kujdesin institucional dhe promovimin e saj", ka theksuar Samir Hoxha, drejtori i QRTK-së në Prizren.

Si rezultat i vjetërsisë së ndërtesës, mungesës së ndërhyrjeve konservuese dhe braktisjes, Kulla në fjalë është në gjendje të keqe fizike dhe rrezikohet nga dëmtimet e mëtutjeshme, andaj është bërë pjesë e programeve investuese të Ministrisë së Kulturës përmes Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren.

Punimet në ndërtimin e objektit të urgjencës në QKMF-në e Malishevës drejt përfundimit

Malishevë, 23 qershor (ER) - Ndërtimi i objektit të urgjencës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Malishevë është duke shkuar drejt përfundimit të saj dhe shumë shpejt Malisheva do të bëhet me një objekt dhe një shërbim profesional në fushën e ofrimit të shërbimit urgjent shëndetësor.

Punimet në këtë objekt të martën i ka parë nga afër i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi, Liridon Hoti. Kryetari Begaj dhe drejtori Hoti

janë njoftuar nga drejtori i QKMF-së, Nuhi Morina, me punimet dhe rëndësinë që ka ndërtimi i këtij objekti, i cili pas futjes në funksion do t'i përmirësojë shërbimet shëndetësore që ofrohen nga shërbimi i urgjencës.

Begaj pasi është njoftuar me punimet që janë duke u bërë është ndarë i kënaqur me ecurinë dhe cilësinë e punimeve në këtë objekt, pasi ndërtimi është duke u bërë sipas standardeve të kërkuara. "Ne jemi duke investuar në të gjitha fushat e infrastrukturës, ndërsa investimet në

shëndetësi janë një prej prioriteteve tona, pasi kemi obligime në raport me shërbimet shëndetësore dhe jemi duke dhënë maksimumin e mundshëm në këtë drejtim, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira shëndetësore", ka thënë Begaj. Qyteti i Malishevës, që gjendet në mes të Kosovës, i ka më së largu qendrat spitalore, prandaj ofrimi i shërbimit shëndetësor të urgjencës është tepër i nevojshëm dhe për këtë qëllim komuna është duke investuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.



Thaçi dhe Hoti harmonizojnë qëndrimet para udhëtimit në ShBA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Para udhëtimit për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë takuar të martën dhe i kanë harmonizuar qëndrimet për një përfaqësim sa më të mirë të Republikës së Kosovës në këtë takim të rëndësishëm në Shtëpinë e Bardhë. "Presidenti Thaçi dhe kryeministri Hoti kanë vizion të qartë dhe pajtueshmëri të plotë për një përfaqësim shtetëror sa më

dinjitoz në rifillimin e dialogut, i cili pritet të jetë i vështirë. Republika e Kosovës është e bekuar me mbështetjen e partnerëve të saj strategjikë dhe krerët shtetërorë kanë shprehur optimizëm se ky proces do ta përmbyllë kapitullin e hidhur të luftës dhe do ta forcojë paqen në gjithë rajonin tonë", është bërë me dije në njoftimin e zyrës së Presidencës.

Thaçi dhe Hoti nuk janë prononcuar për media pas takimit.

Takimi në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor do të mbahet nën organizimin e të dërguarit të

posaçëm të Shtëpisë së Bardhë për bisedimet e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, pas marrjes së garancive se të dyja palët janë pajtuar që të ndalohen fushatat për tërheqjen e njohjeve për Kosovën dhe të ndalohen kërkesat e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Grenell ka thënë se takimi në Shtëpinë e Bardhë është rast që t'i hapen dyert zhvillimit ekonomik dhe investimeve dhe se shpreson që krerët e Kosovës dhe të Serbisë do ta shfrytëzojnë këtë rast për kthim në dialog.



Anulohet Haxhi për vitin 2020

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 23 qershor - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) ka njoftuar opinionin se për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19 dhe rrezikut që ky virus bartë në vete, Ministria Saudite e Haxhit dhe Umres ka marrë vendim për anulimin e Haxhit për vitin 2020. "Duke pasur për bazë se

numri i personave të vdekur ka arritur në gjysmë milioni, ndërsa numri i të infektuarve ka arritur në më shumë se 7 milionë persona, autoritetet saudite kanë vendosur që Haxhi këtë vit të kryhet vetëm nga personat brenda territorit të Arabisë Saudite. Duke respektuar rekomandimet dhe sqarimet e institucioneve shëndetësore në Mbretërinë e Arabisë Saudite, por edhe në

shumicën e vendeve të botës, në lidhje me rreziqet e vazhdueshme që rrjedhin nga kjo pandemi, mungesës së një vaksine në dispozicion dhe një kure për të infektuarit, Ministria Saudite e Haxhit dhe Umres ka njoftuar se ka marrë këtë vendim për ta ruajtur sigurinë e shëndetit publik", është bërë me dije në njoftimin e BIK-ut.

Sipas njoftimit të BIK-ut, në këtë njoftim të autoriteteve saudite

këtë vit ritualin e Haxhit do ta kryejnë vetëm personat që ndodhen brenda territorit të Arabisë Saudite dhe jo të vendeve të tjera. Po në këtë vendim thuhet se kjo masë është gjykuar si e domosdoshme për ta parandaluar përhapjen e virusit Covid-19. "Duke nisur nga ky njoftim, Bashkësia Islame e Kosovës me keqardhje njofton të gjithë qytetarët e Kosovës se

Drejtoria e Haxhit nuk do të kryejë asnjë procedurë në lidhje me kryerjen e Haxhit për këtë vit, duke respektuar vendimin e Ministrisë Saudite të Haxhit dhe Umres. Lusim Allahun e Madhëruar që të gjithë atyre personave që kanë pasur njetin për kryerjen e Haxhit, t'ua pranojë si adhurim të kryer, ndërsa të na mundësohet që Haxhin ta kryejmë vitin e ardhshëm!", ka njoftuar BIK-u.



MPB-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Shërbyesve Civilë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ministria e Punëve të Brendshme ka shënuar të martën 23 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Shërbyesve Civilë.

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, uroi të gjithë punonjësit civilë të Republikës së Kosovës për punën e madhe që po bëjnë në të mirën e shtetit dhe të qytetarëve. "Përkundër gjendjes së pandemisë, që e ka

kapluar tërë botën, shënimi i kësaj dite në Republikën e Kosovës ka një rëndësi të veçantë, sidomos në këtë vit kur Ministria e Punëve të Brendshme në agjendën e vet ka fillimin e zbatimit të pakos së re ligjore në Administratën Publike, kërkesë kjo e shumëpritur nga nëpunësit civilë", ka thënë ministri Veliu.

Ai ka shtuar se mundësia e zhvillimit të shërbimit civil dhe e ngritjes së kapaciteteve shpërfaqë më së miri aftësinë e

shtetit për t'u marrë me reformat dhe me plotësimin e kriterëve të domosdoshme nga procesi i integriteteve evropiane të vendit. Në fund të kësaj ceremonie është bërë ndarja e 63 mirënjohjeve për kontributin dhe angazhimin e nëpunësve më të dalluar të vitit paraprak. Dita e Shërbyesve Civilë, 23 Qershori, ka filluar të shënohet me vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 dhjetor 2002.



Odat ekonomike kërkojnë veprim të shpejtë të Kuvendit për implementimin e masave në mbështetje të biznesit

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Shpërthimi i pandemisë Covid-19 dhe kufizimi i aktiviteteve ekonomike me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë ka bërë që gati të gjitha ndërmarrjet në Kosovë të ballafaqohen me vështirësi në operimin e tyre, mbijetesa e një pjese të të cilave rrezikohet në mënyrë serioze.

Me qëllim të mbështetjes së ndërmarrjeve dhe punonjësve të goditur nga pandemia, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

që nga ditët e para të shpërthimit të pandemisë kanë kërkuar ndërhyrjen e institucioneve të shtetit me qëllim të ruajtjes së ndërmarrjeve dhe vendeve të punës. "Meqë asnjë nga masat në mbështetje të bizneseve nga Pakoja Emergjente Fiskale nuk janë zbatuar deri në fund, edhe për shkak të nevojës së kryerjes së rishikimit buxhetor për vitin 2020, e pa të cilin nuk mund të fillojë as zbatimi i masave të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, kërkohet demonstrimi i konsensusit politik



dhe veprimit të shpejtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për rishikimin buxhetor dhe për aprovimin e marrëveshjeve

ndërkombëtare për financimin e masave të parapara për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë Covid-19", theksohet

në reagimin e këtyre odave ekonomike.

Në fund Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shprehin besimin e tyre se vonesa për implementimin e masave nga Pakoja Emergjente Fiskale si dhe nisjen e implementimit të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike do ta vonojë edhe mbështetjen për shumë ndërmarrje të cilat sot ballafaqohen me vështirësi në operimin e tyre e rrjedhimisht do ta vonojë edhe rikuperimin ekonomik të vendit.

Përfundon fushata 'Besa për Kosovën', 100 pakot e fundit shkojnë në SOS Fshatrat

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - "Besa për Kosovën diaspora në ndihmë të atdheut gjatë COVID-19", fushata e organizuar nga rrjeti i parë i bizneseve shqiptare Fondacioni "BESA" nga Bavaria, Klubi i Prodhuesve të Kosovës, organizata GERMIN, së bashku me Fondacionin Global Shqiptar, kanë përfunduar me shumë sukses edhe aksionin e fundit të dërgimit të 100 pakove në SOS Fshatrat e Fëmijëve.

"Besa për Kosovën" është fushatë humanitare e cila filloi gjatë muajit prill dhe kishte për qëllim që t'u vijë në ndihmë komunave të ndryshme të



Kosovës të cilat ishin në gjendje të rëndë gjatë kësaj kohe, duke

u shpërndarë pako me produkte ushqimore dhe

produkte bazë të higjienës, me produkte "MADE IN KOSOVA". Kjo për të ndihmuar fuqizimin e prodhimit në Kosovë që ta marrë veten dhe t'u ofrojë ndihmë familjeve në nevojë", thuhet në njoftimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, nga kjo fushatë u ndihmuar shtatë komuna me 1 900 pako, ku 1 900 familje apo rreth 7 200 qytetarë të cilët ishin në gjendje të rëndë financiare për shkak të pandemisë Covid-19. "Edhe 220 punëtorëve në sektorin e prodhimit iu mundësua paga mujore. Komunat të cilat u ndihmuar gjatë kësaj fushate

janë Vitia, Kamenica, Vushtrria, Podujeva, Gjakova, Podujeva, Skenderaj dhe në SOS Fshatrat e Fëmijëve. Jemi shumë falënderues edhe ndaj prodhuesve vendorë për mbështetjen dhe ndihmën ndaj familjeve në nevojë në Kosovë. Faleminderit shumë për Laberion, Floil, Korporata Rugove, Flutra, Finnesa, Qumështorja Vita, Koral Hygiene Products, Happy Wet Wipes, Pi&Ki, Camel, Prince Quick, Ananas Impex, Meka, The North Unicorn - Deppo Market, Evko, që ishit me ne në këtë rrugëtim", thuhet në njoftim.

Auditori kërkon përmirësime në sigurinë e informacionit të sistemeve statistikore

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar Raportin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit "Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës".


Auditimi është kryer në këtë agjenci që është bartëse, shpërndarëse dhe koordinatore e statistikave zyrtare të Kosovës. Ky auditim përfshin periudhën 2019-2020 dhe kishte për qëllim ta vlerësojë organizimin dhe qeverisjen e teknologjisë së informacionit lidhur me kontrollin e sigurisë së të dhënave, kontrollin e aplikacioneve si dhe ruajtjen e integritetit të të dhënave.

Rezultatet e auditimit tregojnë se agjencia përmes sistemeve të teknologjisë së informacionit në përgjithësi ka arritur t'i realizojë

dhe t'i publikojë projektet statistikore të parapara me planin e publikimeve. Megjithatë, nuk kishte vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollin e përgjithshme të teknologjisë së informacionit, që përfshijnë mjedisin në të cilin aktivitetet janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur.

Ka mungesë të vlerësimit adekuat të nevojave në fushën e teknologjisë së informacionit, ndarje joadekuate të detyrave dhe përgjegjësi të stafit si dhe ka staf të pamjaftueshëm të teknologjisë së informacionit. Po ashtu, menaxhimi i aktiviteteve të teknologjisë së informacionit nuk është mjaftueshëm i bazuar në politika, procedura dhe procese të operimit.

Agjencia nuk kishte marrë hapat e mjaftueshëm për t'u siguruar



që informacioni i përpunuar nuk ekspozohet ndaj palëve të paautorizuara. Mungojnë politikat që trajtojnë çështjet e sigurisë së informacionit si dhe ndërgjegjësimi mbi kërkesat e përgjithshme të sigurisë së informacionit nga personeli i

Agjencisë ka rezultuar i mangët. Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka theksuar se rezultatet e auditimit tregojnë se çështjet lidhur me sigurinë e informacionit rreth sistemeve statistikore kanë nevojë të

përmirësohen. Në veçanti, sipas tij, sistemet e teknologjisë së informacionit duhet të forcohen para fillimit të proceseve të rëndësishme të parapara për vitin 2021 siç janë realizimi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Duke marrë parasysh rëndësinë që kanë statistikave në nivel shtetëror, Osmani tha se Zyra Kombëtare e Auditimit i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës që posaçërisht t'i adresojë çështjet rreth sigurisë së informacionit dhe kapaciteteve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Ndërsa me qëllim të adresimit të shpejtë të çështjeve rreth menaxhimit dhe qeverisjes së teknologjisë së informacionit brenda Agjencisë, ka dhënë 13 rekomandime për Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor tejkalojnë kufijtë e ndotjes



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Dy vjet e gjysmë që nga legjislacioni i kontrollit të ndotjes sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që detyroi qeveritë e Ballkanit Perëndimor t'i zbatojnë normat e BE-së, analiza e re Bankwatch gjen ndotjen e ajrit, kryesisht dyoksidin e squfurit (SO₂) dhe emetimet e pluhurit, të larta nga termocentralet e qymyr, duke ua marrë frymën komuniteteve në të gjithë rajonin dhe më gjerë. Edicioni i vitit 2020 i raportit "Përshtat ose mbyll" ("Comply or Close") tregon se në vend se të afroheni më shumë me pajtueshmërinë, emetimet e SO₂ në termocentralet e qymyrit të mbuluara nga

Planet e Reduktimit të Emisioneve Kombëtare në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi u rritën gjatë vitit 2019.

Emetimet totale të SO₂ nga termocentralet e qymyrit në Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut tejkaluan afro gjashtë herë sasinë e lejuar nga planet e vendeve në vitin 2019.

Fajtorët kryesorë ishin në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi, por shqetësuese është fakti se kompleksi i termocentralit Bitola në Maqedoninë e Veriut në vitin 2019 dyfishoi emetimet e SO₂. Kosova është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor për të cilin të dhënat e vitit 2019 nuk ishin publikuar në kohën e shkrimit të raportit, kështu që janë përdorur të dhënat e vitit

2018.

Emetimet e SO₂ të Kosovës për vitin 2018 shënuan rritje prej 20 përqindësh në krahasim me vitin 2017, ose 2.503 tonë në numër absolut.

Termocentrali Kosova B në Kosovë mbeti ndotësi kryesor i rajonit, duke lëshuar 5.4 herë më shumë sesa kufiri i lejuar i emetimeve të tij.

Planet Kombëtare për Reduktimin e Emetimeve janë një mekanizëm që lehtëson procesin për vendet për ta arritur pajtueshmërinë, pasi kufiri i detyrueshëm i emetimeve është vendosur në nivelin kombëtar dhe jo për termocentrale individuale. Deri në fund të vitit 2027 të gjitha termocentralet duhet të jenë në përputhje me shifrat apo limitet e caktuara të emetimeve edhe në baza

individuale. Të gjitha termocentralet e qymyrit të rajonit, përveç disa më të vogla, përfshihen në plane të tilla. "Çdo qeveri që insiston në mbajtjen e vazhdueshme të këtyre termocentraleve të ndyra duhet t'i rritë investimet në pajisjet e kontrollit të ndotjes që mund të përputhen me LCP BREF, standardet më të reja të ndotjes industriale të BE-së. Deri atëherë, orët e funksionimit të termocentraleve duhet të shkurtohen për t'i përmbushur kufijtë e ndotjes në Direktivën e Impiantëve të Mëdha Djegëse që vendet janë angazhuar si pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë", ka thënë Pippa Gallop, këshilltare e Energjisë së Evropës Juglindore në Bankwatch dhe bashkautore e raportit.

Kurse koordinatori i fushatës ballkanike kundër ndotjes së ajrit në Bankwatch, Davor Pehchevski, ka theksuar se gjetjet e tyre alarmante janë një dëshmi për zvarritjen e këmbëve të qeverive që tashmë po merr jetë njerëzore. "Mijëra njerëz në të gjithë rajonin dhe në vendet fqinje të BE-së po vdesin nga ndotja nga këto termocentrale të thëngjillit. Kjo është e papranueshme", ka thënë Pehchevski.

Rinora Gojani, menaxhere e programeve në Balkan Green Foundation, ka thënë se Kosova nuk do të duhet të investojë më në përpjekje me kapacitete të reja të qymyrit. "Qeveria e Kosovës duhet ta transferojë fokusin drejt politikave të gjelbra dhe mbrojtjes së shëndetit publik", është shprehur Gojani.

Hoti dhe Bajrami falënderojnë presidentin e BERZh-it për përkrahje

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti dhe ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, kanë biseduar sot me presidentin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Suma Chakrabarti. Me këtë rast, kryeministri Hoti dhe ministrja Bajrami e kanë falënderuar Chakrabarti për përkrahjen e

vazhdueshme të BERZh-it për Republikën e Kosovës, me theks të veçantë për kredinë emergjente për likuidet me vlerë prej 30 milionë eurosh si dhe për mbështetjen e projekteve të kompanive rajonale, për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme etj. Gjatë këtij bashkëbisedimi,

kryeministri Hoti ka thënë se takimet e kësaj jave në Uashington dhe në Bruksel do të përqendrohen kryesisht në integrimin ekonomik rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndërsa ministrja Bajrami ka paraqitur prioritetet e Qeverisë së Kosovës për rimëkëmbjen ekonomike të vendit.



Në prag të dialogut në Uashington



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Kërkesa për t'i "dhënë diçka Serbisë", që ambalazhohet "si kompromis", është kërkesë për t'i kënaqur xhelatët që kryen gjenocid në Kosovë.

Në prag të takimit të 27 qershorit të delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë në Uashington gjithnjë e më tepër përsëritet deklarata e nënkryetarit të LDK-së, Lutfi Haziri, se "në procesin e dialogut me Serbinë, Kosova do të japë diçka, Kosova duhet të ofrojë diçka për ta përballuar këtë proces, sepse ne nuk mund të themi se po shkojmë atje dhe do të kapitalizojmë 100 për qind kërkesat tona".

Kjo qasje e neveritshme është në harmoni të plotë me qasjen e Aleksandar Vuçiqit dhe Ivica Daçiçit, të cilët vazhdimisht trumbetojnë se Serbia nuk mund të humbë çdo gjë dhe se asaj duhet t'i jepet diçka nga Kosova.

Aleksandar Vuçiqit, Ivica Daçiçit, Lutfi Hazirit dhe të gjithë atyre që mendojnë si ata, u themi se që nga okupimi i Kosovës nga Serbia, për realizimin e pavarësisë nga ky shtet, populli shqiptar i Kosovës ka

dhënë:

- Qindra mijëra viktime të spastrimit etnik të territoreve shqiptare që përpara okupimit serbe hynin në atë që quheshin Sanxhak i Nishit dhe Vilajet i Kosovës;

- Dëbimi i 1/3 së popullsisë shqiptare në Turqi me qëllim të realizimit të spastrimit etnik;

- Dhjetëra mijëra të vrarë dhe qindra mijëra të burgosur përpara se të shpërthente lufta e vitit 1998-1999;

Vetëm gjatë luftës së fundit kur u zbatua politika e gjenocidit të shtetit serb mbi popullin shqiptar, Kosova ka dhënë:

- 1392 fëmijë të vrarë

- 1739 gra të vrara

- Mbi 10 mijë civilë tjerë të të gjitha moshave

- Mbi 20 mijë gra të dhunuara

- Mbi 1 milion njerëz të dëbuar me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës

- Shkatërrimin e 100589 shtëpive të shqiptarëve

- Shkatërrimin e 358 objekteve shkollore shqipe

- Shkatërrimin e 30 shtëpive kulturore shqiptare

- Shkatërrimin e 93 bibliotekave në vendbanimet shqiptare

- Shkatërrimin e 123 institucioneve shëndetësore

- Shkatërrimin e 220 objekteve të kultit fetar (215 xhami, teqe, tyrbe dhe 5 kisha katolike).

Për pavarësinë e vet Kosova ka dhënë shumë gjak dhe sakrificë dhe nuk ka çka jep asgjë më shumë. Përkundrazi, në kontekst të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndër-shtetërore:

- Serbia duhet të jep llogari për gjenocidin që kreu në Kosovë!

- Serbia duhet t'i jep drejtësisë ndërkombëtare tërësinë e njerëzve të zinxhirit që kreu këtë gjenocid;

- Serbia duhet të ndriçojë fatin e mbi 1600 njerëzve që janë

zhdukur gjatë procesit të fshehtësë së gjurmëve të gjenocidit; Prandaj, kërkesa për t'i "dhënë diçka Serbisë", që shpesh ambalazhohet "si kompromis", që të na njohë pavarësinë e shtetit tonë është kërkesë për të kënaqur xhelatët që kryen gjenocid në Kosovë. Aleksandar Vuçiqit, Ivica

Daçiçit, Lutfi Hazirit dhe të gjithë atyre që mendojnë si ata, u themi se çështja e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë është çështje politike, që varet edhe nga vullneti i saj. Ndërsa pranimi i krimit të gjenocidit në Kosovë është çështje e drejtësisë dhe duhet t'i imponohet Serbisë!



Batakçinjtë e Tiranës dhe Vuçiqi famëmadh



Denion NDRENIKA

Fitorja e Aleksandër Vuçiqit, president i Serbisë, në zgjedhjet e së dielës së 21 qershorit 2020, prej shumëkujt shihet si mbështetje për, kinse, "europianistin" apo nga shumëkush tjetër si mbështetje për "autokracinë".

Marr shkas shkurtimisht për këtë shkrim nga komentet e munguara, ndonëse mund të fshihen pas qenies shtetarë të drejtuesve të Shqipërisë apo nga ish-ministri i Jashtëm, Tritan Shehu, që mbështet të dytën, pra fitoren e autokracisë. Për asnjërin nga të dyja palët nuk ndihem mirë teksa i vërej që nuk flasin shkoqur, shkurt e trup, që cilado parti apo cilido individ të fitojë në Serbi, për

shqiptarët nuk ka kurrfarë fitimi.

Andrijeviqët, karagjorgjevët, millosheviqët, rankoviqët apo cilët do më parë e më pas, kurrë nuk ua kanë krijuar barazinë shqiptarëve të trojeve etnike të Shqipërisë që mbetën jashtë në Londër në 1913, paçka se vullnetplotë ishin shprehur për shtetin e vetëm të tyre në Lidhjen e Prizrenit 1878 dhe vendosur në Kuvendin e Vlorës 1912, shtu edhe Konferencën e Bujanit 1943-1944.

Ndonëse më duhet t'u kërkoj ndjesë lexuesve që e përdor, por fjala dhe sjellja "palaço" u shkon fare mirë për shtati krejt shtetarëve të Shqipërisë në cilëndo kohë, përderisa e trajtojnë një zhvillim për Serbinë dhe serbët aspak si çështje që lidhet me Shqipërinë dhe kur them "Shqipëri" flas për atë që u vendos në Prizren dhe në Vlorë.

Fundi i fundit, askujt nuk duhet t'i vijë keq sepse çka shkruaj, mbështetet qartë në tërë historinë e marrëdhënieve

sllavo-shqiptare, ndonëse ndarazi mund të shihen si me serbët, malazezët apo bullgarët.

I veçoj sepse nga të tri këta popuj sllavë ne shqiptarët kemi rënë pre e gjenocidit, masakrave, dëbimeve, shpopullimeve, marrjes dhunshëm të trojeve të Shqipërisë në çdo rast, me apo pa traktate ndërkombëtare nga Nishi në Ohër, nga Podgorica në Manastir, nga Vranja në Kërçovë, nga Ulqini e Tivari në Shkup e Kumanovë e ngado Luginës së Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, Tërnocit, Rrozhajës, Vuthajve, Malësisë, Tuzit, krejt an' e mbanë ku na dha Zoti diell dhe tokë.

E kujt i bëhet vonë nëse me Vuçiqin ka europianizim apo amerikanizim të Serbisë, kur Serbia nuk ka reshtur dhe sa na tregon analiza historike, ase se do të reshtë ndokur së vrari e masakruari shqiptarët?

Domosdo që shpesh them dhe tash e rithem, se i përcmoj lex-

uesit dashakeq të shkrimeve se kinse jam armiqësor apo nuk dua marrëdhënie të mira me fqinjët.

Unë vetëm theksoj fort se për palaçollëkun e Shqipërisë, zhvillimet në Serbi na u dashkërka t'i shohim si europianizuese apo më së paku siç thotë zoti Shehu, autokratike. Me apo pa europianizim, me apo pa autokraci, ftoj këdo të më thotë se çfarë ka ndryshuar në marrëdhëniet kriminale serbe ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë.

Mos vallë ndokush nga serbët apo sllavët ka thënë se Shqipëria ka të drejtën të ketë shtetin e saj siç u vendos në të vetmet Kuvende Mbarëkombëtarë të Prizrenit dhe Vlorës sot e kësaj dite të pashfuqizuar prej kurrkujt, përfshi batakçinjtë ndarës të kohëve të reja?

E përderisa askush në Serbi nuk hedh hapin madhor të rivendosjes së të drejtës së Shqipërisë për shtetin e saj të vetëm sikurse u shpall vullneti në Prizren dhe

vendimi në Vlorë, nuk ka mundësi ta shohim Serbinë dhe serbët si të shpëtuar nga europianizmi apo amerikanizmi vuçiqist apo gjynahqarë nga autokracia vuçiqosëse.

Vetëm rikthimi i Shqipërisë në kufijtë e Prizrenit dhe Vlorës e ndreq Ballkanin dhe ua mbyll gojën të vetëquajturve shtetarë të rinj apo kujdestarë të trojeve të Shqipërisë të sakatuara nga sllavët dhe grekët.

Andaj, shpresa apo çmimi vlerësues për fitoren e Vuçiqit, apo keqardhja për autokracinë e Vuçiqit në Serbi, as që kalon nga marrëdhëniet me shqiptarët, sikundër historia masakruese, gjenocidiale serbe nuk na dëshmon ndonjë rishikim të krimeve të tyre ndaj nesh.

Me apo pa Vuçiq, serbët mbeten me kohë e pa kohë, gjenocidiale kundër shqiptarëve.

Ah, për kujtesë, më thoni nëse kanë kërkuar së paku ndjesë sa për sy e faqe për qindra vjet gjenocid. Pra, për fund, asnjë ndryshim nuk ka për shqiptarët nga cilido fitues në Serbi.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (14)

Cilat ishin gjërat e shenjta të Adem Jasharit...



Bedri ISLAMI

Adem Jashari, miti, legjenda dhe e vërteta

Flamuri ishte gjëja tjetër e shenjta e Adem Jasharit. E kishte në ballin e kullave, e kishte në makinën e tij, e kishte nëpër këngët që i dinte, e kishte në mal me vete, në fund të fundit e kishte aq pranë sa u bënë pjesë e njëri-tjetrit. (...) Për besë, edhe sikur dhjetë herë shtet të ishte Kosova dhe të kishte dhjetë flamurë shtetërorë, Adem Jashari nuk do të ndahej nga flamuri dyshkabash, i cili ishte pjesë e jetës së tij.

Në dhjetorin e vitit 1997 Adem Jashari dhe grupi i Drenicës dërgojnë një letër, letra e fundit e tyre kjo, në strukturat që i takonin. Janë disa faqe, të shkruara nga Hamza dhe e firmosur nga të gjithë të tjerët. Në të gjitha rreshtat nuk është shkruar asnjë fjalë për vete, asnjë fjalë për familjen e tij dhe nuk e kishte pasur kurrë, gjithë jetës së tij, në mend një gjë të tillë. Me një respekt të jashtëzakonshëm shkruan për Abedin Rexhën dhe luftën e tij, tregon se si luftuan shokët, si vepruan për të pasur një qëndresë sa më të fuqishme dhe vetëm në fund, si duket duke e ndërë se lufta do të ishte shumë më tepër se deri atëherë, bën një kërkesë, tepër të zakonshme, "kemi nevojë për më shumë armatim".

Adem Jashari është njeriu që hyn dhe del nëpër legjendë, ashtu si njerëzit e zakonshëm hyjnë e dalin nëpër oborrin e shtëpisë së tyre. Mbi të gjitha miti i tij, legjenda dhe e vërteta për të ka një akt kulmor, në tri kohë të ndryshme, që lidhet me tri rrethimet që i janë bërë kullës së tij.

Në jetën e kujtdo, pra edhe në jetën e Jasharëve, zënë vend natyrshëm gjërat që i kanë më për zemër, që i kanë bërë të shenjta dhe i mbajnë ashtu derisa ta kenë frymën e fundit. Adem Jashari, njeri i fjalës së paktë, kishte bërë shenjtërimin e gjërave për të cilat jo vetëm ia vlejte të luftojë, por edhe të flijoheshë. Kur e kishte menduar një gjë të tillë, ai e kishte quajtur çdo gjë të zakonshme e normale, njëlljosi ditët e jetës së përditshme, si frymëmarrja e zakonshme apo përtëritja e stinëve.

Por le t'i sjellim disa shembuj për të shkuar te gjërat e shenjta të Adem Jasharit dhe të gjithë fisit të tij. Shembulli i parë ose shenjtërimi i parë:

Në thyerjen e natës së 30 janarit

1991 ndodh rrethimi i parë i Jasharëve. Tre djemtë e shtëpisë, Rifati, Hamza dhe Ademi, pasi nisnin luftën, çajin rrethimin dhe zënë vend bri malit, pikërisht aty ku sot ndodhen varrezat. Prej atje vazhdojnë të luftojnë, pasi u kanë ardhur në ndihmë edhe bashkëluftëtarët e tyre.

Baca Shaban ka qëndruar gjatë tërë kohës në kullë, stoik si ai, i qetë, duke e ditur se tashmë lufta ka nisur dhe, si çdo luftë, edhe ajo do të ketë të rënët e saj. Policia serbe, pasi kishte lënë të vrarët e parë, përforcohet me mjete luftarake: vijnë helikopterët, tanku fillon të lëvizë drejt kullave dhe më në fund futen në oborrin e shtëpisë.

Kur futen brenda, njëri prej drejtuesve të policisë serbe e pyet bacën Shaban: "Të kujt janë gjithë këto shtëpi dhe pasuri?"

Të miat, të djemve dhe të nipave të mi - i a kthen baca Shaban, ndërsa oficeri, duke parë rreth e rrotull, gjithë atë mall e gjë, i drejtohet edhe një herë plakut të urtë: "A kanë mend këto djemtë e tu që po luftojnë, kur i kanë gjithë këto të mira?"

Po, i kanë, veç liri nuk kanë - i kthen baca Shaban dhe ata fillojnë ta godasin, të tërbuar nga përgjigja e qetë dhe e urtë e plakut të shtëpisë. Pastaj fillojnë e godasin edhe Lulëzimin që bën ti dalë për zot gjyshit të tij.

Në të vërtetë Jasharët i kishin të gjitha, mall e gjë, shtëpi të ngritura dhe që mund të ngrinin edhe në të ardhmen, toka dhe livadhe, vaden e ujit dhe maqina, një jetë të sigurt ekonomike dhe mund ta shkonin ashtu gjithë jetën e tyre, duke pritur që dikush tjetër t'i lëvizte gjërat nga vendi. Mund ta bënë këtë. Jo pak e kishin bërë, ishin mbyllur rreth avlisë së oborrit të tyre sa pa rënë nata dhe kishin fjetur, në gjumin e madh të haresës.

Adem Jashari nuk mund ta bënte këtë, sepse e kishte të shenjta lirinë. Dhe nuk e kishte në përmasa të zakonshme, ashtu si mund ta kenë edhe shumë të tjerë. Ai i falej asaj, e adhuronte atë, e kishte vënë mbi veten dhe mbi gjithë fisin e tij.

Kjo do të thoshte se ai kishte pasur një fillësë të mbarë drejt pavdekshmërisë. Nuk e kishte bërë me mendje një gjë të tillë. Zakonisht gjërat e shenjta njerëzit i mbajnë thellë vetes së tyre. Adem Jashari e kishte mbajtur kështu, thellë vetes, dëshirën për të qenë i lirë, qoftë edhe me kulla të djegura, qoftë edhe pas rënies së tij.

Shembulli i dytë ose shenjtërimi i dytë:

Ishte viti 1989. Kohë e turbullt, por jeta duhej vazhduar gjithsesi. Duheshin përshpejtuar brezat, duheshin bërë dasmat, duheshin marrë nuset. Mirëpo në këtë vit fatkobra policia serbe dilte nëpër

rrugë, ndalonte krushqit e dasmorët, i zbriste nga makinat apo ua priste udhët, i hiqte flamurin dyshkabash dhe ua shkelte me këmbë, ua griste dhe pastaj fillonte të qëllonte. Kështu kishte ndodhur jo vetëm në këtë vit fatkobra, kështu kishte ndodhur që kur mbahej mend se kishim filluar të jetonin nën shikje. Kishte pasur këngë për njerëzit që nuk e kishin hequr flamurin dhe ishin vrarë për të. Por në fundin e një shekulli kjo ishte edhe më e rëndë. Në këtë vit marotohej një mik dhe bashkëluftëtar i Adem Jasharit. Më pas ai do të ishte edhe përfaqësuesi i tij në perëndim, Ramiz Lladrovci "Veshi". Njerëzit në shtëpinë e vjetër të Lladrovëve ishin bërë gati të niseshin për të marrë nusen. Në dhomën e

asaj dite duhej një burrë si Adem Jashari. Flamurit i duhej një njeri i tillë. Ishte viti 1989, dy vite para se të ndodhte rrethimi i parë i kullës së tyre dhe të niste kështu të shkruhej historia e legjendshme e Jasharëve.

Kam pyetur më vonë tek Lladrovçët, se si kishte ndodhur më pas. Makinat ishin nisur. Në mesin e tyre qëndronte Adem Jashari, i heshtur, i bindur se po bënte detyrën e tij, i gatshëm të sakrifikohej. Si duket policët kishin marrë vesh se do të kishte qëndresë, askush nuk i ndali. Në shtëpinë e nuses u shkrepën armë sa të dëgjoheshin dhjetëra kilometra tej, por as në kthim askush nuk i ndali.

Më shumë se dhjetë vetë ma kanë treguar këtë histori. Të gjithë



dasmorëve hyri Fehmi Lladrovci.

"O njerëz, u tha, po nisemi me marrë nusen". Të tjerët miratuan me kokë dhe dikush bëri të ngrihej. Fehmiu vazhdoi. "Nusen do e marrim me flamur". Të tjerët përsëri tundën kokat. "Mirëpo flamurin nuk e japim. Në se dalin përpara milicët serbë, luftën e bëjmë dhe flamurin nuk e japim. Mendohuni mirë, kush e ndjen veten të aftë për të mbrojtur flamurin, le të bëhet gati, të tjerët, nuk ua marrim për të keq, le të rrinë në shtëpi".

Kur doli nga dhoma, Fehmiu u tha miqve të afërt: "Çojini fjalë Adem Jasharit, tregoni se po shkojmë të marrim nusen me flamur dhe flamurin nuk e japim".

Asaj dite Ademi kishte një rast gëzimi në shtëpinë e tij. Mirëpo i lë të gjitha, merr makinën, e ngarkon me pushkë automatike dhe mitraloz, fut në sediljen prapa bombat e borës dhe fishekë të tjerë, mbështjell rreth saj flamurin e madh, mbi kokë vë kësulën e bardhë dhe niset.

E kishin thirrur miqtë e tij. Por nuk ishte vetëm kjo, atë e kishin thirrur se donin të mbronin flamurin, se ishin të gatshëm të luftonin për flamurin dhe e dinin mirëfilli se

njëlljosi dhe të gjithë, po ashtu, njëlljosi të gëzuar se u kishte rënë në fat të udhëtonin një herë me Adem Jasharin për të mbrojtur flamurin.

Flamuri ishte gjëja tjetër e shenjta e Adem Jasharit. E kishte në ballin e kullave, e kishte në maqinën e tij, e kishte nëpër këngët që i dinte, e kishte në mal me vete, në fund të fundit e kishte aq pranë sa u bënë pjesë e njëri-tjetrit.

Për besë nuk e di se çfarë do të kishte thënë Adem Jashari për flamurin e sotëm të Kosovës. Nuk e di, por mendja ma merr se do të kishte rrudhur supet, do të ishte munduar të gjente diçka nga ajo që kishte pasur dhe në se nuk do e kishte gjetur, do të kishte thënë "le të jetë hë për hë edhe ky, deri sa të bëhemi një shtet dhe vjen prapë flamuri ynë, që edhe kështu nuk po e heqim".

Për besë, edhe sikur dhjetë herë shtet të ishte Kosova dhe të kishte dhjetë flamurë shtetërorë, Adem Jashari nuk do të ndahej nga flamuri dyshkabash, i cili ishte pjesë e jetës së tij.

Shembulli i tretë:

Isha mik një natë tek familja e Jasharëve dhe, pas bukës, ndërsa po pinim çajin tradicional, të cilin

unë e pëlqej vetëm kur jam me drenicas, filluam të shohim disa filmime nga jeta e familjes së tyre, para ngjarjeve të marsit të vitit 1998. Ishte një ditë e zakonshme, krejt e zakonshme, gjithë diell, ftohtë, pasi kishin ngrirë rrekezat e ujërave dhe Adem Jashari ishte me fëmijë dhe nipër në oborrin përbrë. Fëmijët po luanin me njeri-tjetrin, ai krasiste diçka, pastaj fliste e luante me fëmijët, diçka i ngacmonte dhe ata i përgjigjeshin, pushka ishte lënë pak mënjane, kishte një sopat në dorë dhe herë pas here çante dru. Sytë i shkëlqenin më shumë se zakonisht, ndjehej se ishte i lumtur në këtë çast pushimi, kur kishte lënë pas, qoftë edhe përkohësisht punët e luftës. Herë pas here shikonte andej nga ku duhej të ishte mali.

Pastaj e kam parë tek rrinte me nënën e tij, mbesën e Shaban Polluzhës së njohur, e kam parë tek ia merrte duart e buta, me rrudhat e moshës, në duart e tij të forta, por që jo rastësisht i përdhelnin aq butë. I shërbente asaj, i a rregullonin dy djemtë, ai dhe Hamza, jastëkun pas supeve, qeshnin me të, pastaj diçka i thoshin për vitet e saj që nuk po plaknin dhe, pas një copë here, ndërsa po nisej për në aksion, i thoshte, krejt zakonshëm, si të shkonte për një punë të çfarëdoshme "hajt, natën e mirë e bafshi".

Gjithçka ishte më shumë se e zakonshme, ishte, si të thuash, një fragment nga jeta e secilit bujk. Kushdo mund të ishte ai, por në se e vështroje me vëmendje, mund të dalloje shumë lehtësisht mallin e tij, ndjenjën e afërsisë, të respektit dhe të mirënjohjes për familjen e tij.

Adem Jashari e kishte të shenjta familjen e tij. Ky ishte një tjetër shenjtërim i tij. Ai përgjigjehej për nënën dhe fëmijët, për dajallarët dhe nipërit e mbesat, kishte një marrëdhënie shumë të afërt me të atin e tij, si prind, si mësues dhe si prijës, bënte hoka me të vëllanë e tij më të madh, të cilin e vinte mbi gjithçka.

Rifat Jashari kujton, kur u kthehe vitin 1996, ilegal në shtëpinë e tij:

"Kur shkova të fle, Ademi m'i solli armët dhe disa bomba, ndërsa unë i thashë: 'Largomi këto 'hekura' se unë nuk rehatohem natën'. Ademi më tha 'Ja ku i ke dhe bën çfarë të duash me to'. Para se ta mbyllte derën e dhomës, më dha një porosi: 'Nëse vijnë më tepër se dhjetë policë, lajmëromë, për më pak, bëj çka të duash se nuk e prishi gjumin'".

Ai kishte të drejtë ta shenjtëronte familjen e tij, e cila asnjëherë, edhe në momentet më të vështira, nuk i tha se ku po shkon në rrugën e tij dhe se mund të kishte pasoja e gjithë familja. Asnjëherë nuk i thanë të mos bënte tutje, por i ndenjën aq afër, sa në fund dhanë edhe jetën me të. (Vijon)

Gjermania vendos masa të izolimit në nivel lokal

Berlin, 23 qershor - Autoritetet gjermane po vendosin masa lokale të izolimit pas një shpërthimi të infektiveve me koronavirusin e ri në një fabrikë të mishit. Më shumë se 1 300 punonjës të fabrikës në Tonies kanë dalë pozitivë në testin për koronavirus. Kryeministri i shtetit të Rhein-

Westfalisë, Armin Laschet, tha se kufizimet do të kthehen në rrethin Gutersloh, që ka rreth 360 000 banorë. Kjo shënon edhe rikthimin e parë të masave të izolimit qëkur Gjermania filloi ta heqë bllokimin e saj në muajin maj. Laschet tha se bllokimi do të zgjasë deri më 30 qershor dhe

e përshkroi vendimin si një "masë parandaluese". Gjermania është vlerësuar gjerësisht për reagimin e saj ndaj pandemisë, por ka shqetësime që numri i të infektuarve po rritet përsëri. Por, autoritetet kanë theksuar se shpërthimet mbeten të lokalizuara.



Kufijtë e BE-së mund të mbeten të mbyllur për vendet e Ballkanit Perëndimor

BRUKSEL, 23 QERSHOR - Kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian mund të mbeten të mbyllur për qytetarët e Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor edhe pas datës 1 korrik pavarësisht prej rekomandimit të mëhershëm të Komisionit Evropian që këta kufij të hapen me këtë datë.

Komisioni Evropian para dy javësh kishte rekomanduar që kufijtë e brendshëm të BE-së të hapen jo më vonë se më 15 qershor, ndërsa ata të jashtëm prej 1 korrikut.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, Komisioni kishte rekomanduar që kufijtë e jashtëm të hapen prej 1 korrikut, duke e arsyetuar në atë kohë këtë rekomandim me gjendjen e mirë epidemiologjike.

Komisioni kishte konstatuar se kjo situatë në vendet e Ballkanit Perëndimor është "e ngjashme apo edhe më e mirë sesa në vendet e BE-së". Por, prej atëherë situata në rajon është përkeqësuar me rritjen e shpejtë të numrit të të



infektuarve me koronavirus. Kjo ka bërë që disa shtete të BE-së të marrin masa individuale dhe që në nivel të BE-së të vihet në pikëpyetje heqja e kufizimeve për hyrjen në BE të

shtetasve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Zëdhënësi për çështje të migrimit në Komisionin Evropian, Adalbert Jahns, ka thënë se u takon vendeve

anëtare të vendosin për heqjen apo jo të kufizimeve për qytetarët e Ballkanit Perëndimor. "Rekomandimi për nuk ishte vetëm për shkak të situatës epidemiologjike, por

edhe për shkak të raporteve të BE-së me atë rajon. Sa i përket situatës, ne jemi duke e ndjekur me shumë kujdes. Diskutimet në Këshill janë në vazhdim e sipër dhe në ato diskutime merret parasysh edhe situata aktuale epidemiologjike", ka thënë ky zëdhënësi në Komisionin Evropian.

Edhe pse Komisioni Evropian mund të paraqesë rekomandime, vendimi për të hapur apo jo kufijtë u takon vendeve anëtare. Disa vende anëtare të BE-së tashmë janë duke i rritur masat për kufizimin e hyrjes së shtetasve nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Kështu ka vendosur Sllovenia, ndërsa Kroacia kërkon që personat që hyjnë në territorin e saj, e rrjedhimisht edhe në atë të BE-së, ta dëshmojnë arsyen domosdoshme për një udhëtim të tillë.

Në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, ditët e fundit ka pasur një rritje të numrit të të infektuarve me koronavirusin e ri.

Një botë e ndarë nuk mund ta mposhtë pandeminë, paralajmëron OBSH-ja



NYU JORK, 23 QERSHOR - Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se "kërcënimi më i madh me të cilin përballlemi tani nuk është vetë koronavirusi, por mungesa e solidaritetit dhe udhëheqjes globale". "Ne nuk mund ta mposhtim këtë pandemi me një botë të ndarë", tha ai gjatë një videokonference për media.

Në të gjithë botën, më shumë se 9 milionë njerëz janë konfirmuar si të infektuar nga koronavirusi dhe më shumë se 471 000 kanë vdekur, sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins". Më 29 maj presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se Uashingtoni i ka përfunduar marrëdhëniet e tij me Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Trump tha se OBSH-ja, agjenci e

Kombeve të Bashkuara, ka dështuar t'i bëjë reformat "e kërkuara dhe shumë të nevojshme", pas shqetësimeve të ShBA-së për mënyrën se si e ka trajtuar pandeminë e koronavirusit.

Në muajin prill, Trump i ka ndërprerë fondet për OBSH-në, duke e akuzuar atë për fshehje të përhapjes së koronavirusit, pasi është shfaqur në Kinë në muajin dhjetor.

Tetë raste të reja me koronavirus në Mal të Zi

PODGORICË, 23 QERSHOR - Në Mal të Zi janë shënuar tetë raste të reja me Covid-19, sëmundja që shkaktohet nga koronavirusi i ri. Drejtori i Qendrës Klinike të

Malit të Zi, Jevto Erakoviç, i tha televizionit "Vijesti" se tetë rastet e reja u konfirmuan gjatë natës së mbrëmshme (22 qershor) dhe se më shumë informa-


cione do të bëhen publike gjatë ditës së martë. Erakoviç tha se aktualisht 51 persona në Mal të Zi kanë Covid-19. Mali i Zi shpall fundin e epidemisë më 2

qershor, pas dy cikleve, me gjithsej 28 ditë pa raste të reja të të infektuarve. Por, më 14 qershor sërish u regjistrua një rast me koronavirusin e ri.



DHIMITËR S. SHUTERIQI: NGA E KA PREJARDHJEN KOPJA E VETME QË NJIHET NGA LIBRI I BUZUKUT

Gjon Buzuku dëshmon se për veprën e tij punoi brenda 20 marsit 1554 dhe 5 janarit 1555



“Meshari” i Buzukut u vu, me sa duket, në indeks nga Inkuizicioni, kështu që libri u zhdruk gati krejt dhe sot njihet në një kopje të vetme në Bibliotekën Vatikane. Atë s’e përmend asnjë autor pasardhës përpara Pjetër Bogdanit (1665), Zbulimi që i bëri Nikollë Kazazi (1740) nuk e shpëtoi nga heshtja. U desh që ta rizbulonte Pal Sqiroidi, në fillim të shekullit tonë, që të niste e të bëhej mirë i njohur. Gati tre shekuj e gjysëm heshtjeje kaluan mbi librin e parë që dimë të jetë botuar shqip.

Me interes është që të njihet se nga çfarë vendi e ka prejardhjen kopja e vetme e librit të Buzukut. Mbi këtë libër ka disa anëshkrime, ku gjejmë emrat e dy klerikëve që e kanë përdorur atë, një Gjon e një Gjergj, si edhe emrat e tre të tjerëve, të cilët u janë drejtuar dy të parëve me anëshkrimet e tyre, për t’i përshëndetur e për ndonjë porosi: një Mark, një Pjetër e një

Nikollë. Në një faqe, ose në kapakun e fundit të librit, lexojmë edhe emrin e një Kola Kuçi dhe, nën këtë emër, kemi fjalën Asanes. Është pikërisht kjo fjalë që na shpuri të kërkojmë prejardhjen e ksomblës së librit të Buzukut nga fshati i sotëm Hasanaj, pak në jugperëndim të Fushë-Krujës. Ky fshat, më 1431 dhe në pjesën e parë të shek. XVII, thuhet Asanes. Një emër mesjetar sllav.

Duke ditur se libri ka bërë pjesë në Bibliotekën e Kolegjit Urban në Romë dhe e ai kolegji u krijua më 1627, kërkuam dokumentet fill përpara dhe pas kësaj date. Në një relacion të njohur të Marin Bicit, të vitit 1610, hasëm në të dhëna me interes të veçantë për fshatrat midis Krujës dhe detit, pranë Asanesit. Kështu, në qershor të atij viti, në Laç ka qenë famulltar një Gjon, ndërsa në Qullës të zonës së Rodonit një Gjergj. Po në këtë zonë, në Muzhëll ka qenë famulltar një Mark (vendas) e

në Shporaj një Nikollë, kurse midis këtyre fshatrave dhe Asanesit, në Bëllaj (sot Bilaj), shërbente një Pjetër. Janë pikërisht të pesë emrat që hasim në anëshkrimet e përmendura. Marin Bici na mëson se famulltari i Qullësit ishte, Gjergj Bardhi (i quajtur në dokumente të tjera Maqedoni), i cili shërbente edhe si vikar (zëvendës) i peshkopit të Randësisë, d.m.th. të rrëzave të Krujës e gjer në det. Është pikërisht ai që ka edhe shkrimin më të mirë. Duke qenë më me kulturë se shokët, ai është ngjitur në hierarki. Llagapët e të tjerëve nuk i dimë, po Nikolla i Shporajt mundet që është Kola Kuçi, të cilin e gjejmë edhe në Asanes.

Që 5 klerikë, emrat e të cilëve i gjejmë bashkë në anëshkrimet mbi librin e Buzukut, t’i gjejmë bashkë edhe në fshatrat pranë Asanesit, në një kohë jo shumë pas botimit të librit, kjo tërheq vëmendjen. Anëshkrimet na bëjnë të mendojmë se Gjoni dhe

Gjergji jetonin pranë e pranë, ndërsa tre të tjerët si grup më vete. Gjergji, duke qenë vikar, duhet të ketë qëndruar në Laç, qendër kryesore kishtarë e atyre anëve, pra të ish-in shpesh pranë Gjonit. Libri siguriht ka qenë i Gjonit dhe është përdorur shpesh, me sa duket, nga vikari Gjergji, po herë pas here edhe nga tre të tjerët. Kuptohet se ai libër ishte fort i rrallë, që kur vunë indeks, shumë shpejt mbasi doli, meqë veprimtaria e Inkuizicionit për spastrimin e librave të kishës ka filluar më 1568. Libri ishte në dorë edhe të Kola Kuçit në Asanes.

Ksombla e vetme që njihet sot nga libri i Buzukut e ka prejardhjen nga fshatrat e rretheve të sotme të Krujës dhe Durrësit, fill në të dy anët e lumit të Ishmit, në zonën fushore dhe kodrinore bregdetare, midis Laçit, Hasanajt e Muzhllit. Që libri e ka prejardhjen nga një zonë bregdetare, këtë e sugjeronte edhe vizatimi i një varke me vela

që dikush prej atyre që e kanë pasur nëpër duar ka bërë mbi të. Ky vizatim përcillet me fjalën Aisa. Me këto fjalë do të thotë Ishëm? Që libri vjen nga ato anë, kjo ka rëndësi për historinë e shkrimit të gjuhës sonë në Shqipërinë e Mesme.

Librin e rrallë të Buzukut ka shumë mundësi ta ketë gjetur e konfiskuar Marin Bici. Misioni i këtij ishte që të zbatonte në Shqipëri porosinë e Inkuizicionit. Ai duhet ta ketë dërguar kështu librin në Romë, bashkë me relacionin që i bëri Vatikanit aty nga fillimi i vitit 1611 për vizitën e tij tek ne në vitin e kaluar. Kjo nuk na ndihmon që të përcaktojmë mirë datën e anëshkrimeve të librit të Buzukut. Po, me siguri, ato s’janë të gjitha të një viti, janë të disa viteve. Mund të thuhet se i përkasin një periudhe që nga fillimet e Inkuizicionit e gjer në dekadën e parë të shek. XVII, kur s’ka botuar akoma gjë Budi, pra, viteve 1568-1610.

E jashtëzakonshme

Shtëpia e vogël në formën e vezës, me çmim prej 90 mijë dollarësh

Ecokapsula krijon shtëpi të vogla që punojnë me energji të erës dhe me energji diellore të cilat mund të vendosen në një bazë rimorkio për gati 90 000 dollarësh. Shtëpia e vogël u projektua për herë të parë nga Nice Architects për një arkitekturë dhe konkurs projektimi të vitit 2008.



FOTO E DITES



Përmbytje nga shiu në Lagos të Nigerisë

E rrallë

Autobusi i braktisur në Alaska largohet me helikopter

Një autobus i braktisur në Alaska, i paraqitur edhe në filmin "Into The Wild", është larguar nga aty pas rritjes së numrit të turistëve të cilët janë përballur me vdekjen dhe rreziqe, në tentimin për ta vizituar atë. Sipas mediave të huaja, ka qenë një



helikopter i ushtrisë amerikane që e barti atë nga një shteg jashtë Parkut Kombëtar Denali.

BARSOLETA E DITËS



- I thirra këta për rrymë, u thashë çka u bo kështu më ka ardhur fatura 75 euro këtë muaj?
- Thanë ju kërkohet falje, kemi bo gabim, se 92 euro të paska ardhur.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Morena poston videon hot nga pishina

Këngëtarja Morena Tarku vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes së mediave për paraqitjet e saj shumë provokative. Ajo është aktive në rrjetet sociale, duke ndarë vazhdimisht me ndjekësit foto të ndryshme nga përditshmëria e saj. Së fundmi, modelja ka ngacmuar imagjinatën me videon e fundit që ka publikuar. E veshur me bikini, Morena shfaqet joshëse dhe seksi teksa del nga pishina.




 <p>DASHI Të jesh i motivuar është shumë gjë e mirë, por është e rëndësishme që të mos lejoni që sukcesi t'ju largojë nga njerëzit që ju duan dhe ju mbështetin.</p>	 <p>DEMI Në këto çaste keni nevojë për më shumë qetësi. Përpiquni të gjeni një vend ku mund të mendoni mbi ndryshimet e ardhshme në jetën tuaj.</p>	 <p>BINJAKËT Ndjenja juaja e mirësjelljes ju ka ndihmuar që të keni marrëdhënie të mira me njerëzit që keni pranë.</p>	 <p>GAFORRJA Nëse ndieni nevojën për të qëndruar pranë shtëpisë dhe për të mbajtur një profil më të ulët sesa zakonisht, atëherë bëjeni këtë.</p>	 <p>LUANI Çdoherë që shpenzoni kohë me fëmijët tuaj do të jetë shumë e dobishme. Në aspektin profesional do t'ju ofrohen shumë mundësi të këndshme.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Nëse keni një mundësi zgjedhjeje midis dashurisë dhe parave, zgjidhni romancën! Mund të takoni dikë që me të vërtetë do të ndezë një zjarr të thellë brenda jush.</p>
 <p>PESHORJA Pse jeni kaq të preokupuar të shikoni prapa në të kaluarën tuaj, kur e ardhmja juaja është shumë premtuese?</p>	 <p>AKREPI Ju mund ta kanalizoni ambicijen tuaj në disa mënyra interesante. Nuk duhet të jetë gjithmonë përpjekja për të qenë personi më i mirë, më i shpejti, më i zgjuari ose më i pasuri.</p>	 <p>SHIGJETARI Ju duhet ta ndiqni mënyrën tuaj dhe t'i bëni gjërat në mënyrë unike. Kjo është mënyra e vetme që ju ta jetoni jetën që dëshironi.</p>	 <p>BRICJAPI Ditët e mëdha si kjo nuk vijnë shumë shpesh, prandaj kënaquni me gjithë qenien tuaj. Argëtoni sa më shumë shqisat tuaja dhe mos i shmangni aventurat.</p>	 <p>UJORI Personat që keni përreth nuk kanë arritur ende t'ju kuptojnë. Është në dorën tuaj t'u tregoni atyre se ju keni mënyrën tuaj autentike të të bërit të gjërave.</p>	 <p>PESHQIT Nëse kaloni shumë kohë duke u përpjekur t'i kënaqni miqtë tuaj në pozita të larta, rrezikoni t'i neglizhoni miqtë e vjetër.</p>

Dua sjell pamje nga festa për ditëlindjen e të dashurit, i dedikon fjalë dashurie




Anwar Hadid një ditë më parë festoi ditëlindjen, duke pranuar urim me fjalët më të bukura nga e dashura, Dua Lipa. Në mbrëmjen e së hënës çifti festoi bashkë, ndërsa nuk hezitoi të ndajë një moment nga ajo mbrëmje bashkë me ndjekësit.

Dua publikoi një video, ku shfaqet duke i dhuruar një puthje Anwarit, ndërsa shkruan "Dashuria ime". Përndryshe, Dua Lipa po shijon suksesin e albumit "Future Nostalgia", ndërsa datat e turneut ende kanë mbetur pezull.



Dua sjell pamje nga festa për ditëlindjen e të dashurit, i dedikon fjalë dashurie

Anwar Hadid një ditë më parë festoi ditëlindjen, duke pranuar urim me fjalët më të bukura nga e dashura, Dua Lipa. Në mbrëmjen e së hënës çifti festoi bashkë, ndërsa nuk hezitoi të ndajë një moment nga ajo mbrëmje bashkë me ndjekësit. Dua publikoi një video, ku shfaqet duke i dhuruar një puthje Anwarit, ndërsa shkruan "Dashuria ime". Përndryshe, Dua



Lipa po shijon suksesin e albumit "Future Nostalgia", ndërsa datat e turneut ende kanë mbetur pezull.

Ledina Çelo po rikthehet në skenën muzikore pas shumë viteve mungesë



Ka vite që Ledina nuk ka sjellë ndonjë këngë apo projekt muzikor. Por, pas shumë viteve, këngëtarja duket se po e mendon rikthimin dhe

ka ndërmarrë hapa konkretë në këtë drejtim. Në llogarinë e saj në "Instagram" ajo postoi një fotografi ku shihet në studio dhe përshkrimi thotë: "Së shpejti".

'Lucifer'-i me shumë surpriza, mësohet data e lansimit



Seriali i cili do të transmetohet në dy pjesë prej tetë episodesh do të rikthehet në faqen e 'Netflix' më 21 gusht, duke kënaqur fansat që kanë qenë të dëshpëruar të dinë se çfarë do të ndodhë me historinë e përfunduar në vitin 2019, shkruan "DailyMail". Netflix njoftoi

datën e lansimit, së bashku me fjalinë e mëposhtme: "Në sezonin e pestë mahnitës, aksionet janë më të larta se kurrë. Sekretet do të zbulohen, personazhet e pëlqyera do të vdesin dhe, më në fund, do të marrim një përgjigje për pyetjen 'A do të jenë apo nuk do të jenë?'"



Samanta Schweblin: Zbuloj errësirën përmes letërsisë

Si është Berlina sot?

Krejtësisht dimëror! Ka tri ditë që bie borë e cila ka mbuluar gjithçka. Është pamje e këndshme. Më pëlqen Berlina në ditë si këto.

Pse u shpërngulët për të jetuar në Berlin?

Për shkak të një burse njëvjeçare nga bashkia e Buenos Airesit, diçka vërtet e mrekullueshme dhe një gjest bujar. Në fund të saj ishte e vështirë për t'u rikthyer në jetën reale. Megjithatë, erdha në Gjermani me të dashurin tim i cili është argjentinas dhe ndërsa isha e zënë me të shkruarit, ai bëri atë që bëhet zakonisht kur je i papunë: hapi një bar. Ndodhet në Kreuzberg.

A e bën atmosfera në Berlin më të lehtë për të krijuar art?


Në të vërtetë, është shumë ndryshe nga Buenos Airesi, në aspektin strukturor. E dua shumë Buenos Airesin, por kur erdha këtu, kuptova që mund të punoj më pak dhe të kem më shumë kohë për të shkruar. Këtu mund të organizoj seminare mbi shkrimin tri herë në javë dhe të ardhurat më mjaftojnë për të jetuar.

Më tregoni pak për rrugën tuaj për t'u bërë shkrimtare. Si janë ditët tuaja, tani, si shkrimtare, edhe pse jo shkrimtare me kohë të plotë?

Gjithmonë më tërhiqnin librat dhe rrëfimet. Nisa të shkoj në disa seminare letrare kur isha rreth të shtatëmbëdhjetave dhe s'kam reshtur së shkruari që atëherë. Në Argentinë gjysma e shkrimtarëve organizojnë seminare në shtëpitë e tyre. Si pjesëmarrëse, ishte mahnitëse të mësoja në dhomën e ndenjjes së shkrimtarëve të mi të parapëlqyer, të kisha mundësi të hyja në bibliotekat e tyre dhe të zbuloja një jetë që i përkushtohet të shkruarit nga kaq afër. Tani, ndërsa jetoj në Berlin, dy herë në javë organizoj seminare mbi shkrimin në dhomën e ndenjjes, duke vazhduar traditën. Ishte një zbulim befasisues për mua të shihja se sa shumë njerëz shkruajnë letërsi në Spanjë dhe në Gjermani, dhe e bëjnë kaq seriozisht. Pjesën tjetër të javës jam një shkrimtare me kohë të plotë.

A ka më rëndësi romani? Nëse po, si dhe për kë?

Epo, ka shumë rëndësi për mua. Mendoj se serialët televizivë, lojërat dhe media në



përgjithësi kanë ndryshuar mënyrën se si rrëfjmë histori. Por librat do të mbeten. Teknologjia ka ndryshuar të gjitha artet e tjera: pikturën, teatrin, kërcimin, kinemanë, muzikën. Por letërsia është një proces krejtësisht intim ndërmjet zërit të shkrimtarit dhe mendjes së lexuesit, është diçka kaq e natyrshme dhe e fortë, sa e vetmja gjë që teknologjia mund të ndryshojë, është mbështetja e tij, formati, për shembull, nëse lexojmë një libër të shtypur apo një libër elektronik. Por kjo s'e ndryshon zemrën e letërsisë.

Cilët janë autorët që nuk i lexojnë, por duhet të lexohen nga amerikanët?

Më vijnë kaq shumë emra në mendje, sa është gati e pamundur t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Mësova të shkruaj duke lexuar letërsinë e Amerikës së Veriut, e dashuroj letërsinë tuaj, por kam ndjesinë që nëse një vend lexon vetëm letërsinë që krijon vetë, ai do të mbetet pa oksigjen. E di që këtë vit dy shkrimtare të tjera argjentinas do të përkthehen në anglisht: Leila Guerrero, një kronikane e mprehtë, dhe tregimet e Mariana Enriquez të cilat me subjektet e tyre

rrëqethëse dhe të llahtarshme të bëjnë të zgjohesh në mes të natës. Shumë gjëra po ndodhin me shkrimtarët bashkëkohorë në Amerikën Latine. Ndoshta kjo do të ishte një pikë e mirë nisjeje.

Cilat janë romanet që do të donit t'i kishit shkruar?

Nganjëherë mendoj "Njeriu i tretë" i Flen O. Brajenit (Flann O'Brien) dhe nganjëherë "Shpikja e Morelit" e Adolfo Bioy Casares.

Cilin autor po lexoni tani? A lexoni letërsi ndërsa shkruani, apo lexoni poezi ose libra joletrarë?

Miqtë dhe shkrimtarët janë udhëheqësit e mi më të besuar për sa u përket leximeve. Unë gjithmonë mbaj parasysh rekomandimet që më japin njerëz që më duken interesantë. Nganjëherë s'janë shkrimtarë dhe librat e tyre të parapëlqyer nuk janë letërsi, por ide të mëdha që mund të burojnë prej saj.

Meqë ra fjala tek idetë e mëdha, libri juaj është theksuar nga shumë kritikë se nuk është një libër i zakonshëm. A ishte kjo e qëllimshme? A synonit të shkruanit diçka të ndryshme?

Është e vështirë t'i përgjigjesh, por do të përpiqem. Për mua, krijimi i tensionit është një nga gjërat më të rëndësishme gjatë leximit dhe të shkruarit. Kam nevojë për këtë tension si lexuese, por gjithashtu kam nevojë për të kur po shkruaj ose kur s'mundem të vijoj të punoj me librin. Kur e filloj një libër, që nga ideja më e parë, me të vërtetë që kam nevojë të ndiej që ajo që po bëj është diçka vërtet e re, sepse nëse nuk është, nuk është e mundur që ajo që po shkruaj të marrë vëmendjen time. Kur isha e vogël dhe ende s'kisha mësuar të shkruaja, e kisha zakon t'i rrëfeja histori nënës sime. Isha afërisht pesë ose gjashtë vjeçe dhe çdo natë i tregoja histori. Më kujtohet që zbuloja ndjesinë që isha në gjendje të prekja me të vërtetë dikë tjetër me historitë e mia dhe çka është edhe më e mira, nëse sajoja diçka vërtet dramatike, kjo do të thoshte se mund ta shndërroja historinë dhe të tërhiqja vëmendjen ndërkohë që e doja kaq shumë atë. Nuk janë të shumta çastet në jetë kur dikush tjetër do të të dëgjojë, kur ti arrin të rrokësh plotësisht vëmendjen e tij. Është një ndjenjë magjepsëse dhe kur jam duke shkruar, përpiqem ta përjetoj këtë çast.

Le të flasim pak për rolin e kafshëve në "Largësi shpëtimi", për rolin e kuajve dhe insekteve.

Dua ta tregoj këtë lloj fuqie që

ato kanë, gjithashtu ngaqë Davidi ka informacion të cilin ne nuk e kemi, e kam fjalën për ne lexuesit dhe për Amandën. Ai di shumë për vdekjen dhe në një vend ku njerëzit po vdesin nga kimikatet, edhe kafshët po vdesin. Davidi e ka këtë fuqi për të ndihmuar ata që po vdesin. Ai e ka këtë marrëdhënie me të gjitha gjërat në botë mes jetës dhe vdekjes, të gjitha gjërat që janë në një lloj purgatori.

Jam prind dhe më pëlqeu shumë ideja e "largësisë së shpëtimit", tërheqja që Amanda thotë se ndien sa herë që e bija është larg saj.

Doja të jepja një ngjyresë të veçantë, vërtet të veçantë, të kësaj ideje që nëse do të vijë fundi i botës, ai do të fillojë nga nëna. Lidhja me Davidin është ajo lidhje që ekziston kur gjërat bëhen aq të trishtuara sa të përmbledhësh të gjitha fatkeqësitë e botës, kur çdo gjë është e tmerrshme, drama e vogël e dy ose tri personazheve mund të jetë me të vërtetë e rëndësishme. Mund të jetë fillimi i diçkaje me të vërtetë të thellë, ku një pyetje e thjeshtë të ndihmon të dish ku fillon e keqja dhe nëse e di se ku është e keqja, mund ta luftosh atë. Kur kjo ndodh, çdo gjë bëhet e rrezikshme. Kjo është arsyeja që "largësia e shpëtimit" prishet: çdo gjë në botën ku jeton Amanda është e rrezikshme.

Pse përqendrohet ky roman te nënat dhe jo te baballarët?

Mendoj se kjo është e lidhur me jetën time. Në kujtesën time, burrat në familjen time ishin të dobishëm në shumë mënyra, si për shembull duke bartur gjëra të rënda, ndërsa kur nuk shkonte diçka që lidhej me shpirtin, emocionet, ishin gratë ato që merreshin me këtë gjë. Kjo jo ngaqë burrat s'donin t'ia dinin, por sepse s'e kuptonin dhe s'mund të dukeshin sikur po merreshin me gjëra të tilla. Në fund të "Largësi shpëtimi", kur të gjitha gratë kanë ikur, të vetmit që mbeten janë dy baballarë të cilët duan të përkujdesen, por që nuk arrijnë të krijojnë vërtet komunikim.

Pse Davidi këmbëngul t'i thotë Amandës që "kjo s'ka rëndësi" për të vijuar ecjen përpara? Çfarë do të thotë kjo?

Kur po shkruaja librin, shumë herë kisha ndjesinë që Davidi i kërkon Amandës të vazhdojë përpara, që ai në të vërtetë po më kërkonte mua ta bëj këtë, duke më thënë të vijoj me këtë mënyrë të ndryshme të shkruarit. Një metaforë interesante për atë që ia vlen dhe nuk ia vlen ta thuash! M'u desh kohë të gjeja zërin e Davidit. Shkrova afërisht dymbëdhjetë fillime të

ndryshme, prej pesë ose gjashtë faqesh secili, duke u përpjekur të gjej zërin e rrëfimit. Në fund të atij procesi dëgjoj zërin e Davidit që flet me Amandën. Në fillim mendova që dialogu i tyre do të ishte pjesë e romanit. Pastaj kuptova që dialogu ishte romani. Ishte vetë historia që më tregoi se si ta rrëfeja.

Sëmundja dhe shkatërrimi global janë probleme globale. A mund të ndodhnin ngjarjet e romanit tuaj diku tjetër, apo mund të ndodhnin vetëm në Amerikën Latine?

Kjo histori mund të ndodhte kudo. Në të vërtetë, hera e parë që dëgjova për pesticidet dhe pasojat e tyre të tmerrshme ishte nëpërmjet një dokumentari mbi këtë temë në Francë. Por, para së gjithash, për shkak

të korrupsionit Amerika Latine ka ligjet dhe marrëveshjet më të këqija me kimikatet. Dhe Argjentina, sidoqoftë, është një nga importueset më të mëdha të sojës, një nga produktet më të lidhura me pesticidet. Ne e shpërndajmë këtë sojë në të gjithë botën, është baza e një pjese të madhe të ushqimit tonë. Soja është gjithçka: biskotat, peshqit e ngrirë, buka, supat dhe të gjitha llojet e miellit, madje edhe e akullores!

Si shihet situata e tanishme politike amerikane në Gjermani, Europë dhe në pjesën tjetër të botës?


Mendoj se ne të gjithë jemi vërtet të shqetësuar. Këtu në Gjermani, rrethi im i miqve nuk është i lumtur me Donald Trump-in si presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara,

megjithëse e djathta europiane e simpatizon atë. Dhe si një latino-amerikane ju siguroj që e djathta populiste mund të jetë vërtet e rrezikshme.

Ai i flet një libër si yti politikës moderne më shumë se një libër joletrar? Pse po ose pse jo?

Po, i flet politikës moderne, por në një mënyrë të ndryshme. Letërsia nuk mund të jetë informuese, didaktike apo indoktrinuese, por mund të lërë një gjurmë të vërtetë në frikërat e tua, mund të hapë dritare në mendjen tënde, të të bëjë të vësh në dyshim diçka për të cilën s'ke menduar kurrë më parë. Dhe nganjëherë kjo është po aq e rëndësishme sa një informacion aktual, madje edhe më i besueshëm. *Përktheu nga anglishtja Granit Zela/Exlibris*





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Zbulohen rrathët olimpikë

Komiteti Olimpik i Kosovës ka shënuar Ditën Olimpikë dhe me këtë rast janë zbuluar rrathët olimpikë. Kryetari i KOK-ut, Besim Hasani, ka vlerësuar se kjo ditë e gjënë Kosovën në pozitë të mirë, pasi shumë sportistë i kanë siguruar normat olimpikë



Hasanin, u rrimë gati këtyre ngjarjeve të cilat japin përtej mesazhe për zhvillimin e sportit, për zhvillimin e sportit në përgjithësi. Tashmë ne jemi pjesë e olimpiadës, ku kemi sportistë të shkëlqyer dhe ata do

të jenë figura kryesore që do t'i frymëzojnë të rinjtë e tjerë. Kjo skulptura sot, megjithëse i ka ngjyrat më të bukura, Prishtina është fisnikëruar me një monument siç janë rrathët e olimpiadës të cilët kanë mesazh

për zhvillimin e sportit për paqe në vende të ndryshme të botës", ka thënë Dumoshi. Kujtojmë që shkak të problemeve me pandeminë globale Covid-19, Dita Olimpikë po shënohet ndryshe nga vitet e kaluara.

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Komiteti Olimpik i Kosovës ka shënuar 23-qershorin - Ditën Olimpikë, me ç'rast ka zbuluar rrathët olimpikë. Në këtë ceremoni të pranishëm, përpos Hasanit, ishin edhe ministrja për Kulturë, Rini dhe Sport, Vlora Dumoshi dhe drejtori i Departamentit të Sportit, Ibër Alaj.

Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, gjatë kësaj ceremonie është shprehur se kjo ditë e gjen Kosovën në një çast mjaft të mirë duke marrë parasysh numrin e normave olimpikë të fituara nga sportistët e Kosovës. "Dita Olimpikë lidhet me themelimin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, më 23 qershor në vitin 1894, është themeluar Komiteti Olimpik për ringjalljen e Lojërave Olimpikë moderne dhe nga atëherë çdo katër vjet mbahen Lojërat Olimpikë,

përgjithësisht gjatë dy luftërave botërore dhe këto të fundit që janë shtyrë por, pavarësisht nga kjo, kjo ditë e gjen Kosovën në një moment shumë të mirë, ku kemi pesë norma olimpikë nga xhudo, kemi normën olimpikë edhe nga mundja, por normalisht që presim edhe nga ndonjë sportist tjetër të ketë normë olimpikë dhe të përfaqësohemi sa më mirë në Lojërat Olimpikë 2020 të cilat do të mbahen në vitin 2021", ka thënë Hasani.

Ndërsa ministrja Vlora Dumoshi u shpreh se rrathët olimpikë kanë pasuruar edhe më shumë Prishtinën pasi, sipas saj, kanë një vlerë të madhe për sportistët dhe të rinjtë kosovarë. "Ky është një moment i jashtëzakonshëm. Sot më 23 ne po shënojmë Ditën Botërore të Olimpiadës. Kjo do të thotë shumë se si ne si shtet, si komunitet olimpik në krye me

Shtatorja e Fadil Vokrrit zbulohet në fund të tetorit



PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka zbuluar se skulptura e legjendës Fadil Vokrrit nuk mund të shpalojë edhe për disa muaj. Në seancën plenare të mbajtur të martën në Kuvendin e Kosovës, deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, kërkoi nga ministrja që kjo shtatore të shpalojë para ndeshjeve të

para të Përfaqësueses së Kosovës, të cilat zhvillohen në muajin shtator. Mirëpo Dumoshi ka thënë se kjo punë është e përcaktuar në kontratën që e kanë nënshkruar me skulptorin. "Unë shumë kisha pas dëshirë që kjo skulpturë të bëhet para lojës, por kemi afate në kontratën që e kemi nënshkruar. Do ta përcjellim

nga afër punën dhe do t'i kërkojmë skulptorit nëse ka mundësi ta përfundojë më herët", ka thënë Dumoshi. "Ministria e Sportit dhe Kulturës ka parashtruar kërkesë që parku dhe shtatorja të vendosen te stadiumi i kryeqytetit. Finalizimi i shtatores dhe parkut do të bëhet deri në fund të muajit tetor", ka thënë Dumoshi.

Sot zhvillohen tri ndeshje në Superligë

Prishtinë, 23 qershor - Sot (e mërkurë) do të zhvillohen tri ndeshjet e javës së 26-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Drita dhe Gjilani kërkojnë fitoret e radhës kundër Vushtrrisë dhe Dukagjinit në mënyrë që ta vazhdojnë garën për titull në elitë. Dy skuadrat

kundërshtarë të klubeve nga Gjilani thashmë kanë humbur të gjitha shpresat për mbijetesë, por në ndeshjet e fundit kanë treguar se dinë të jenë të papërshtatshme për kundërshtarët. Në ndeshjen tjetër në Mitrovicë, Trepça '89 e pret Flamurtarin në

ndeshjen që të dyja skuadrat luftojnë për mbijetesë. Aktualisht këto klube kanë pesë pikë diferencë dhe me një fitore eventuale, Flamurtari do t'i shtonte edhe më shumë shanset për mbetjen në elitë. Tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të enjten.

IPKO Superliga

Të mërkurën takohen:
16:45 Trepça '89 - Flamurtari
16:45 Dukagjini - Gjilani
16:45 Vushtrria - Drita
Të enjten takohen:
16:45 Feronikeli - Drenica
16:45 Llapi - Prishtina
16:45 Ferizaj - Ballkani



Liga 1 nuk ndryshon formatin për sezonin 2020/2021

PARIS, 23 QERSHOR - Liga 1 nuk ndryshon formatin dhe nuk "ngushtohet", siç pritej ose parashikohet gjatë kësaj periudhe ku futbollit është ndaluar deri në

korrik. U mendua se do të reduktohej numri i ekipeve pjesëmarrëse për sezonin 2020-2021, por nuk është marrë parasysh nga Federata e Futbollit. Në mbled-

hjen e zhvilluar të martën u diskutua pikërisht për këtë gjë dhe kjo ide është hedhur poshtë nga bordi drejtues. 74.49 % të votave zgjodhën ta vazhdojnë sis-

temin aktual, pra me 20 ekipe. Më pas erdhi edhe konfirmimi zyrtar se Liga 1 do të zhvillohet me 20 ekipe, të paktën edhe për sezonin 2020/2021.



Alaj: Do të ishte nder për mua nëse ftohemi nga Kosova

PRISHTINE, 23 QERSHOR - Federata e Hendbollit e Kosovës vazhdon të angazhohet në përpjekje për ta rritur konkurrencën në ekipet përfaqësuese të Kosovës në hendboll. U takon përzgjedhësve dhe shtabeve teknike që ta bëjnë përzgjedhjen e lojtarëve, por rritja e konkurrencës vlerësohet me shumë rëndësi.

Armend Alaj është lojtari i radhës që është vënë në dispozicion të Përfaqësueses së Kosovës. Alaj është pjesë e skuadrës gjermane ThSV Eisenach, që garon në Bundesliga 2, që shquhet për nivelin që ka. Alaj ka pasur shtetësi të Kosovës, ndërsa së fundi ka aplikuar edhe për pasaportë të Kosovës. "Për mua do të ishte nder i madh nëse selektori do të më ftonë në ekipin përfaqësues. Vitin e kaluar Taip Ramadani ka sinjalizuar për një interes për mua dhe për vëllanë tim, Qëndrimin që, gjithashtu, luan hendboll dhe ka marrë pjesë në disa stërvitje të organizuara nga FHK-ja. Mirëpo disi ka humbur kontaktin", ka thënë Alaj, i cili shpreson se do të marrë ftesë nga Kosova dhe se mund të japë kontribut për ngritjen e mëtejme të cilësisë. "Unë jam lojtar që gjuaj me të dyja duart. Mund të paraqitem në shumë pozicione. Zakonisht



luaj alo e djathtë, por edhe alo e majtë dhe në pozitën qendrore", ka shtuar ai.

Alaj merret me hendboll që nga mosha tetë vjeçe. Klubi Eisenach është tradicional, ka 30 vjet që luan në Bundesliga 1 apo Bundesliga 2. Alaj ka kaluar të gjitha grupmoshat te ky klub. "Më pas dy vjet kam luajtur në ligën e katërt, në klubin Goldbach. Si i ri kam qenë edhe reprezentues i landit të Thuringenit në kampionatet gjermane. Pastaj jam kthyer prapë në Eisenach në ligën e tretë dhe vitin e kaluar prapë në ligën e dytë federative të Gjermanisë. Vitin e kaluar kam qenë i rregullt në stërvitje dhe

kam pasur shtatë paraqitje për klubin nën drejtimin e trajnerit me famë botërore, Sead Hasanefendiç, prej të cilit kam mësuar shumë. Nuk kam qenë edhe aq shumë i kënaqur me hapësirën, por konkurrenca ka qenë shumë e fortë. Klubi mori lojtarë nga Liga e Kampionëve, kështu që kisha më pak shanse ta tregoj talentin tim. Mirëpo mundësitë i kam shfrytëzuar maksimalisht dhe klubi ka qenë i kënaqur me mua", ka treguar 25-vjeçari i cili është me prejardhje nga Deçani. Ai ka kontratë që edhe edicionin e ardhshëm të luajë për Eisenachun në ligën e dytë gjermane.

Dy botërorë futbollit në një vit

NION, 23 QERSHOR - Futbollit ndërkombëtar, për shkak të pandemisë Covid-19, ndryshoi kalendarin dhe kjo nga shtyrja e Kampionatit Evropian, te spostimi i kampionateve e deri te shtyrja e afatit të transferimeve. FIFA po përgatitet për të mos i lënë asgjë rastësisë në vitin 2022. Ai do të jetë viti i Botërorit në Katar, por edhe i Botërorit të Klubeve. Dy evenimentet madhore të organizuara nga Konfederata Botërore e Futbollit. Botërori i Klubeve është parashikuar të zhvillohet gjatë muajve të verës, mes qershorit dhe korrikut, ndërsa Kupa e Botës është programuar të zhvillohet në fund të vitit, mes muajve nëntor dhe dhjetor. Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, hodhi idenë që edicioni i ri i Botërorit të Klubeve të inaugurohet gjatë verës së vitit 2022, duke përfutur edhe nga



spostimi i Kupës së Botës në periudhën e dimrit. Sipas projektit të miratuar, 24 skuadra klubesh do të marrin pjesë në formatin e ri të Botërorit të Klubeve, ku vetëm nga pjesëmarrja do të përfitojnë 20 milionë euro. Fituesi i trofeut, përveç lavdisë, do ta përfitojë çmimin prej 100

milione eurosh. Në evenimentin e FIFA-s pritet që të marrin pjesë tetë skuadra evropiane, të cilave do t'u shtohen edhe gjashtë klube nga Amerika e Jugut. 10-të vendet e mbetura do të plotësohen me ekipe Amerika Veriore, Azia, Afrika dhe Oqeania.

SHKURT

Rashica, synim i Milanit

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, është objektiv i Milanit në afatin kalimtar të verës. Rashica në fund të sezonit pritet të largohet nga Werder Bremani, kurse klauzola e largimit të tij është 16 milionë euro. Sipas "Sky Sport", është zhvilluar një takim mes administratorit Ivan Gazidis dhe Ralf Rangnick, ku janë hedhur synimet për afatin kalimtar, kurse Rashica është në krye të listës.

Gjokoviç diagnostifikohet me Covid-19

Kampioni botëror në tenis, Novak Djoković, ka dalë pozitiv në testin e koronavirusit. Djoković ka thënë në një deklaratë se edhe gruaja e tij ka dalë pozitive, ndërsa fëmijët e tij negativë. Ai është shprehur se nuk ka simptoma të sëmundjes Covid-19. Njoftimi vjen pasi tre tenistë, Borna Ćorić i Kroacisë, Grigor Dimitrov nga Bullgaria dhe Viktor Troicki i Serbisë, u testuan pozitivë, pasi luajtën në një turne me Djokovićin javën e kaluar. "Gjithçka e bëmë me një zemër të pastër dhe qëllime të sinqerta. Turneu ynë ishte i një karakteri humanitar, me idenë për t'i ndihmuar tenistët nga rajoni, për t'u siguruar atyre kushte për të luajtur, për të gjeneruar të ardhura dhe në këtë mënyrë më lehtë ta kapërcejnë këtë periudhë të vështirë", ka thënë Djoković.

Aguero pritet të mungojë dy javë

Manchester City ka bërë me dije se Sergio Aguero ka pësuar lëndim në gju në përballjen ndaj Burnleyt. "Citizens" fitoi me rezultat të thellë 5-0 në përballjen me kundërshtarin nga Liga Premier në kuadër të javës 30. Ai u zëvendësua në fund të pjesës së parë nga Gabriel Jesus. Argentinasi do të shkojë në Barcelonë për tretman të mëtejshëm, kurse pritet të mungojë të paktën dy javë te kampioni në fuqi i Ligës Premier.

Juve arrin marrëveshje me Barçën për transferimin e Arthurit

Është arritur marrëveshja në mes të Barcelonës dhe Juventusit për kalimin e mesfushorit Arthur në Torino. Lajmi është konfirmuar nga "Sky Sport", që shkruan se italianëve u ka kushtuar plot 80 milionë euro ky operacion. Thuhet se të dyja klubet kanë rënë dakord dhe shumë shpejt mesfushorin brazilian do ta shikojmë me bluzën bardhezi. Arthur pëlqehet shumë nga trajneri Maurizio Sarri i cili dëshiron ta ndërtojë mesfushën rreth brazilianit dhe e donte me çdo kusht te ekipi i tij. Raportohet se marrëveshja është arritur dhe shumë shpejt pritet edhe zyrtarizimi. Gjithashtu, raportohet se të dyja palët po punojnë që të mbyllin gjithçka rreth këtij transferimi brenda 30 qershorit, me lojtarin që do të kalonte në Itali pas përfundimit të sezonit aktual.

Tre lojtarë pritet të largohen nga Bayerni

Corentin Tolisso, Javi Martinez dhe Lucas Hernandez mund të jenë lojtarët e parë që do të largohen nga Bayern Muncheni. Për dy të parët largimi është thuhet i sigurt, mbetet për t'u vlerësuar vetëm situata e Lucas Hernandezit. Francezi që erdhi për 80 milionë euro nga Atletico e Madridit ende nuk ka bindur pasi ka vuajtur shumë nga dëmtimet. Flick kërkon lojtarë që ofrojnë siguri dhe për këtë arsye Hernandez mund të sakrifkohet. Deri tani kjo gjë nuk ka ardhur dhe për këtë arsye po mendohet të mbahet Jerome Boateng edhe për të paktën dy vjet të tjera, derisa "bavarezët" të kenë piketuar një lojtar tjetër. Ndërkohë, në dyshim janë edhe Kingsley Coman me Ivan Perisic. Francezi mund të rikthehet te Parisi, ndërsa kroati tek Interi, edhe pse trajneri Antonio Conte ua ka bërë të qartë drejtuesve se nuk kërkon ta mbajë lojtarin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogocit
Zyra e Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLGOC
GLLGOC MUNICIPALITY

Pronar 19.06 2020

Nj. Org. Numër Shitje V:

01-464/01-21154



Në vështrim të nenit 13, 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, nenit 97 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.12-464/01-16598, të datës 27.05.2020, Vendimit Nr.020-343/2, të datës 15.06.2020 të MPL-së, për ligjshmërinë e vendimit Nr.12-464/01-16598, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

- I. Apropovet kërkesa e subjektit kërkuar, Komunës së Drenasit/Glllogocit për shpronësimin e pronave të paluajtshme të pronarëve, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Krojkovë. Qëllimi për të cilin shpronësohen këto parcela, ka të bëjë me projektin për funksionalizimin e sistemit të ujësjellësit, në zonën kadastrale në Krojkovë, të burimi i ujit dhe rezervuari ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë edhe pompat, për të furnizuar banorët e Komunës së Drenasit me ujë të pijes, me kompensimin e pronave të shpronësuara të pronarëve, sipas tabelës së bashkangjitur me këtë vendim.
- II. Pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, njoftohen pronarët e pronave të cilat do të shpronësohen, e që brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit i njëjti do të shpallet në gazetën zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
- III. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkuar dhe cili do person i cili është pronar ose zotëruar i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria Për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit/Glllogocit.
- V. Vendimi hyn në fuqi me datën e shpalljes së tij në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Kryetari i Komunës
Rajshad Madrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorive përkatëse;
- Arkivit të Komunës së Drenasit/Glllogocit.

PARAQITJA TABELARE E PARCELAVE PER SHPRONSIM

Z.K.K. Drenas						Z.K. KROJKOVË						
Gjendja e vjetër						Gjendja e re						
Nr.	Pronari	Nr. parcelos	Kultura-Klasa	Sipërfaqja m ²	Liqi i ndryshimit dokumenti në të cilin bazohet ndryshimi	Nr.	Pronari	Nr. i parcelës	Kultura-Klasa	Sipërfaqja e mbetur m ²	Sipërfaqja për sipërfaqja e shpronësuar m ²	Venjetë
1	Podrimqaku Muharrem 1/4 Podrimqaku Shaban 1/4 Podrimqaku Avdyli 1/4 Podrimqaku Nam 1/4	207-2	mugë	737		24	Komuna Drenas	207-2	Sipërfaqja e shpronësuar	737		
2	Podrimqaku Tahiri/Shaban	211-4	lv. x/4	150			Komuna Drenas	211-4	Sipërfaqja e shpronësuar	150		
3	Podrimqaku Muharrem 1/4 Podrimqaku Shaban 1/4 Podrimqaku Avdyli 1/4 Podrimqaku Nam 1/4	208-4	mugë	464		26	Komuna Drenas	208-4	Sipërfaqja e shpronësuar	464		
TOTAL:					1351	TOTAL:					1351	

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "SKAB Group" Sh.p.k Vushtri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për grumbullimin, klasifikimin e riciklimin e mbeturinave të plastikës dhe grumbullimi, klasifikimi e ballimi i mbeturinave metalike si dhe grumbullimi i mbeturinave të akumulatorëve në Bajinë, Vushtri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.07.2020 në ora 13:45 në hapësirat e restorant "Bajnska" magjstralja Vushtri-Mitorvicë, në Vushtri do të organizohet debat publik nga kompania "SKAB Group" Sh.p.k Vushtri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për grumbullimin, klasifikimin e riciklimin e mbeturinave të plastikës dhe grumbullimi, klasifikimi e ballimi i mbeturinave metalike si dhe grumbullimi i mbeturinave të akumulatorëve në Bajinë, Vushtri.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Miliona" SH.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810858251.
- N.SH. "M&M Lights" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 601038145.
- Erzana Ramanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Naim Frasheri " Kibaje.
- Shkodran Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesën e vitit XIII shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

Sot u bënë një vit pa më të dashurin,
bashkëshortin tim

SKENDER KALLABA

(21.01.1943-24.06.2019)


Të rënda qenkan ditët kur mungon prania jote. Në këtë përvjetor qenka shumë vështirë të shkruaj për ty, por megjithatë jam krenare që pata një bashkëshort siç ishe ti. Dashuria, mirësia dhe urtësia që kishe ndaj familjes dhe farefisit, më bën që mos të harroj kurrë.

Të jetosh në zemrat e atyre që lë pas, do të thotë të mos vdesësh kurrë.

Gjithmonë krenarë që të patëm dhe shumë të pikëluar që të humbëm.

Edhe pse nuk je më fizikisht me ne, në zemrat tona do të jetosh gjithmonë.

Të kujton me shumë mall: Bashkëshortja Sevdija.



Një vit pa babanë tonë të dashur

SKENDER KALLABA

(21.01.1943-24.06.2019)

Mungesa jote është një zbraçeti që nuk plotësohet kurrë. Ndërsa kujtimi dhe malli për ty do të jenë pjesë e jetës sonë baba. Vdekja të ndau prej nesh por jo edhe nga zemrat tona.

Kudo rreth nesh gjenden fjalët, buzëqeshja dhe veprat e tua që do të mbeten përjetë udhërrëfyes për ne.

Të përkujtojnë me shumë mall: vajza Miradije Kallaba Nevzadi me bashkëshortin Ilisain, fëmijët Valmiri, Vlëra, Valdrini dhe Vesa.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

